

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2025

PËR MBIKËQYRJEN SHITESË TË INSTITUCIONEVE TË KREDITIT, SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE DHE SHOQËRIVE KOMISIONERE, PJESË E KONGLOMERATEVE FINANCIARE¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I QËLLIMI DHE IDENTIFIKIMI I KONGLOMERATEVE FINANCIARE

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për ushtrimin e mbikëqyrjes shtesë të subjekteve të mbikëqyrura, të cilat janë të licencuara në përputhje me aktet ligjore që rregullojnë veprimtarinë e institucioneve të kreditit, shoqërive të sigurimeve, shoqërive komisionere, shoqërive administruese të fondeve të investimeve të hapura me ofertë publike ose shoqërive administruese të fondeve alternative të investimeve të cilat janë pjesë e një konglomerati

¹ Ky ligj është përafshuar plotësisht me:

Direktiva (BE) 2002/87/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 Dhjetor 2002, mbi mbikëqyrjen plotësuese të institucioneve të kreditit, shoqërive të sigurimeve dhe shoqërive komisionere në një konglomerat financiar, si dhe për ndryshimin e Direktivave 73/239/CEE, 79/267/CEE, 92/49/CEE, 92/96/CEE, 93/6/CEE dhe 93/22/CEE të Këshillit dhe Direktivave 98/78/EC dhe 2000/12/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (OJ L 035, 11.2.2003, fq. 1) e ndryshuar nga:

- Direktiva 2005/1/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 9 mars 2005, për ndryshimin e disa direktivave dhe një rregulloreje në lidhje me strukturën organizative të komiteteve të shërbimeve financiare (OJ L 79, 24.3.2005, fq. 9);
- Direktiva 2006/48/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 14 qershor 2006, për fillimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të kreditit (OJ L 177, 30.6.2006, fq. 1); (3) Direktiva 2008/25/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 11 mars 2008, për ndryshimin e Direktivës 2002/87/EC për kompetencat e zbatimit të Komisionit Evropian (OJ L 81, 20.3.2008, fq. 40);
- Direktiva 2009/138/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 25 nëntor 2009, mbi fillimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së sigurimeve dhe risigurimeve (Solvency II) (OJ L 335, 17.12.2009, fq. 1);
- Direktiva 2010/78/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 24 nëntor 2010, për ndryshimin e disa direktivave në lidhje me krijimin e Autoriteve Mbikëqyrëse Evropiane (OJ L 331, 15.12.2010, fq. 120);
- Direktiva 2011/89/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 nëntor 2011, për ndryshimin e Direktivave 98/78/EC, 2002/87/EC, 2006/48/EC dhe 2009/138/EC për mbikëqyrjen plotësuese të entiteteve financiare në një konglomerat financiar (OJ L 326, 8.12.2011, fq. 113);
- Direktiva 2013/36/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 qershor 2013, mbi qasjen në veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe mbikëqyrjen prudenciale të institucioneve të kreditit dhe shoqërive komisionere (OJ L 176, 27.6.2013, fq. 338);
- Direktiva (EU) 2019/2034 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 27 nëntor 2019, mbi mbikëqyrjen prudenciale të shoqërive komisionere dhe për ndryshimin e disa direktivave (OJ L 314, 5.12.2019, fq. 64); dhe
- Direktiva (EU) 2023/2864 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 dhjetor 2023, për ndryshimin e disa direktivave në lidhje me krijimin dhe funksionimin e Pikës së Vetme të Hyrjes Evropiane (ESAP) (OJ L, 20.12.2023, fq. 1)

financiar..

2. Mbikëqyrja shtesë e subjekteve që janë pjesë e një konglomerati financiar kryhet krahas mbikëqyrjes së tyre sipas legjislacionit përkatës të sektorit ku subjekti bën pjesë.

Neni 2 **Përkufizimet**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Institucion krediti” është subjekti që ushtron veprimtari bankare dhe financiare sipas përcaktimeve të legjislacionit për bankat në Republikën e Shqipërisë;

2. “Shoqëri sigurimi” është personi juridik i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ushtruar veprimtari sigurimi dhe operacione të tjera të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me veprimtarinë e sigurimit, sipas përcaktimeve të legjislacionit shqiptar që rregullon veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit;

3. “Shoqëri komisionere” është personi juridik i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, profesioni ose aktiviteti i rregullt tregtar i të cilit është ofrimi i një ose më shumë shërbimesh investimi në tituj palëve të treta dhe/ose kryerja e një ose më shumë veprimtarive të investimit në formë profesionale, sipas përcaktimeve të ligjit që rregullon tregjet e kapitalit në Republikën e Shqipërisë;

4. “Shoqëri administruese” është personi juridik i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, veprimtaria tregtare e të cilit është administrimi i sipërmarrjeve të investimeve kolektive, përfshirë sipërmarrjet për investimin kolektiv në tituj të transferueshëm, fondeve të pensioneve private në zbatim të legjislacionit shqiptar që rregullon veprimtarinë e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, fondeve të pensioneve private, ose të një ligji të barasvlershëm të huaj në fuqi;

5. “Shoqëri administruese e fondeve të investimeve alternative” është personi juridik i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, veprimtaria e së cilës është administrimi i një ose më shumë fondeve të investimeve alternative dhe i cili, krahas kësaj, mund të marrë përsipër funksionet e administrimit dhe të reklamimit të fondeve të investimeve alternative, siç përcaktohet në legjislacionin shqiptar që rregullon veprimtarinë e sipërmarrjes së investimeve kolektive.

6. “Shoqëri risigurimi” është personi juridik i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për ushtrimin e veprimtarisë së risigurimit, sipas përcaktimeve të legjislacionit shqiptar që rregullon veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit.

7. “Subjekt i mbikëqyrur” nënkupton një institucion krediti, shoqëri sigurimi, shoqëri risigurimi, shoqëri komisionere, shoqëri administruese dhe shoqëri administruese të fondeve të investimeve alternative.

8. “Sektor financiar” nënkupton sektorin e përbërë nga një ose më shumë prej subjekteve të mëposhtme:

a) institucion krediti, institucion financiar, shoqëri e shërbimeve ndihmese (në vijim referuar si sektori bankar);

b) shoqëri sigurimi dhe/ose risigurimi, ose shoqëri kontrolluese e sigurimit (ku “shoqëri zotëruese e sigurimeve” nënkupton një shoqëri memë, e cila kontrollon kryesisht shoqëri sigurimi ose risigurimi dhe vetë nuk ushtron veprimtari tregtare jashtë tregut të sigurimeve) (në vijim referuar si tregu i sigurimeve);

c) shoqëri komisionere (në vijim referuar si tregu i shërbimeve të investimeve);

9. “Rregulla sektoriale” nënkupton ligjet, aktet nënligjore, rregulloret, udhëzimet dhe çdo akt tjetër të miratuar në zbatim të tyre, që zbatohen në sektorin financiar përkatës nga secili

autoritet mbikëqyrës.

10. “Kontroll” konsiderohet se ekziston kur një person juridik (personi kontrollues):

a) zotëron më shumë se gjysmën e votave në asamblenë e përgjithshme të një personi juridik tjetër (shoqëria bijë);

b) ka të drejtën të emërojë më shumë se gjysmën e anëtarëve të organeve të administrimit ose mbikëqyrjes së një personi juridik tjetër (shoqërisë bijë) dhe është aksionar ose ortak në atë person;

c) ka të drejtën të ushtrojë ndikim dominues mbi një person juridik (shoqëri bijë) nëpërmjet një kontrate ose aktit të themelimit/statutit të tij, nëse kjo lejohet nga legjislacioni i zbatueshëm;

ç) është aksionar ose ortak në një personi juridik dhe (i) më shumë se gjysma e anëtarëve të organit drejtues ose mbikëqyrës të këtij personi juridik (shoqërisë bijë), gjatë vitit financiar të kaluar dhe në vitin aktual deri në përgatitjen e pasqyrave të konsoliduara, janë emëruar si rezultat i ushtrimit të të drejtave të votës nga subjekti kontrollues; (ii) personi kontrollues, individualisht ose nëpërmjet një marrëveshjeje me aksionarë apo ortakë të tjerë, zotëron më shumë se gjysmën e votave në asamblenë e përgjithshme të këtij personi juridik (shoqërisë bijë).;

d) ushtron, sipas mendimit të autoriteteve mbikëqyrëse, ndikim influencues mbi vendimmarrjen lidhur me veprimtarinë e një personi juridik tjetër (shoqërisë bijë) në çfarëdo mënyre tjetër.

e) Për qëllimet e përcaktimit të ekzistencës së kontrollit sipas shkronjave “a”, “b”, “ç” dhe “d)” të këtij neni, zbatohen rregullat e mëposhtme:

(i) Në rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “ç”, numri i votave të subjektit kontrollues shtohet me: votat që zotërohen nga shoqëritë bijë ndaj të cilave ai ushtron kontroll; dhe votat e personave që, ndonëse veprojnë në llogari të tyre, veprojnë në interes të personit kontrollues ose të shoqërisë së tij bijë.

(ii) Në të njëjtat raste a), b) dhe ç), numri i votave pakësohet me: votat që i përkasin aksioneve të mbajtura për llogari të një personi tjetër nga vetë personi kontrollues ose nga shoqëria e tij bijë; dhe votat që i përkasin aksioneve të dhëna në peng, nëse të drejtat që burojnë prej tyre ushtrohen me urdhër dhe në interes të pengdhënësit.

(iii) Gjithashtu, në rastet e shkronjave “a” dhe “ç”, votat pakësohen gjithashtu me: votat që i përkasin aksioneve të mbajtura nga vetë shoqëria bijë, qofshin të mbajtura drejtpërdrejt, ose përmes një personi të kontrolluar prej saj, ose përmes një personi që përfaqëson veten, por vepron për llogari të personit kontrollues ose shoqërisë bijë.

11. “Shoqëri mëmë” është personi juridik që ushtron kontroll mbi një ose më shumë shoqëri bija.

12. “Shoqëri bijë” është personi juridik që kontrollohet nga shoqëria mëmë. Personat juridikë që janë shoqëri bija të një shoqërie bijë do të konsiderohen gjithashtu shoqëri bija të shoqërisë mëmë.

13. “Lidhje të ngushta” janë rastet në të cilat dy ose më shumë persona fizikë apo juridikë janë të lidhur përmes kontrollit ose pjesëmarrjes, ose një situatë ku dy ose më shumë persona fizikë apo juridikë janë të lidhur në mënyrë të përhershme me të njëjtin person përmes një marrëdhënieje kontrolli.

14. “Grup” është një grup shoqërisë i përbërë nga një shoqëri mëmë, shoqëritë e saj bija dhe shoqëritë në të cilat shoqëria mëmë ose shoqëritë e saj bija zotërojnë pjesëmarrje, si dhe personat që janë të lidhur me njëri-tjetrin nëpërmjet marrëdhënieve të kontrollit të përbashkët, të përcaktuara si marrëdhënie në bazë kontrate ose aktesh themeluese/statutore, ose kur më shumë

se gjysma e anëtarëve të organeve të administrimit apo mbikëqyrjes janë të njëjtët persona gjatë vitit financiar dhe deri në përgatitjen e pasqyrave të konsoliduara. Ky përkufizim përfshin edhe çdo nëngrup të këtyre personave.

15. “Pjesëmarrje” nënkupton situatën kur një person zotëron, drejtpërdrejt ose tërthorazi, 20% ose më shumë të kapitalit ose të votave në asamblenë e përgjithshme të një personi, si edhe kur një person zotëron të drejta në kapitalin e një personi tjetër të cilët, duke krijuar lidhje të përhershme me atë person, kanë për qëllim të kontribuojnë në veprimtarinë e tij.

16. “Konglomerat financiar” është grupi ose nëngrupi, në krye të të cilit ndodhet një subjekt i mbikëqyrur, ose në të cilin të paktën një nga shoqëritë bija të tij përbën një subjekt të mbikëqyrur, dhe që përmbush kushtet e mëposhtme:

a) Në rastet kur një subjekt i mbikëqyrur ndodhet në krye të grupit ose nëngrupit:

(i). subjekti në fjalë është shoqëria mëmë e një subjekti tjetër që bën pjesë në sektorin financiar; ose është një subjekt që zotëron pjesëmarrje në një subjekt tjetër që bën pjesë në sektorin financiar; ose është një subjekt i lidhur me një subjekt tjetër në sektorin financiar nëpërmjet një marrëdhënieje kontrolli, që karakterizohet nga administrim i përbashkët në bazë të një kontrate ose të akteve themeluese/statutore, ose kur më shumë se gjysma e anëtarëve të organeve drejtuese apo mbikëqyrëse të dy subjekteve janë të njëjtët persona gjatë vitit financiar dhe deri në përgatitjen e pasqyrave të konsoliduara;

(ii). të paktën një nga shoqëritë e grupit ose nëngrupit bën pjesë në sektorin e sigurimeve, dhe të paktën një tjetër bën pjesë në sektorin bankar ose në sektorin e shërbimeve të investimeve; dhe

(iii). veprimtaritë e konsoliduara ose të agreguara të personave të grupit ose nëngrupit që i përkasin tregut të sigurimeve, dhe atyre që i përkasin tregut bankar ose tregut të shërbimeve të investimeve, janë të rëndësishme në kuadër të nenit 3, pika 2 ose 3 të këtij ligji; ose

b) Në rastet kur grupi ose nëngrupi nuk ka në krye një subjekt të mbikëqyrur:

(i). veprimtaritë e grupit ose nëngrupit realizohen kryesisht në sektorin financiar, në kuptimin të nenit 3, pika 1 e këtij ligji;

(ii). të paktën një nga shoqëritë e grupit ose nëngrupit bën pjesë në sektorin e sigurimeve, dhe të paktën një tjetër bën pjesë në sektorin bankar ose në sektorin e shërbimeve të investimeve;

(iii). veprimtaritë e konsoliduara ose të agreguara të shoqërive të grupit ose nëngrupit që i përkasin sektorit të sigurimeve, dhe atyre që i përkasin sektorit bankar ose sektorit të shërbimeve të investimeve, janë të rëndësishme në kuadër të nenit 3, pika 2 ose 3 të këtij ligji.

17. “Shoqëri financiare zotëruese e përzier” është një shoqëri mëmë, e ndryshme nga një subjekt i mbikëqyrur, e cila, së bashku me shoqëritë e saj bija, nga të cilat të paktën njëra është subjekt i mbikëqyrur që ka selinë e tij në Republikën e Shqipërisë ose në një Shtet Anëtar të Bashkimit Evropian, dhe subjekte të tjera, përbën një konglomerat financiar;

18. “Autoritete mbikëqyrëse” janë autoritetet shtetërore të ngarkuara me mbikëqyrjen e institucioneve të kreditit, shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, shoqërive komisionere, shoqërive administruese të fondeve të investimeve të hapura me ofertë publike ose shoqërive administruese të fondeve alternative të investimeve, në baza individuale apo në baza të konsoliduara.

19. “Autoritete mbikëqyrëse përkatëse” janë:

a) autoritetet mbikëqyrëse në Republikën e Shqipërisë ose në një Shtet Anëtar të autorizuar për mbikëqyrjen sektoriale në nivel grupi të të gjitha subjekteve të mbikëqyrura në një konglomerat financiar, në veçanti të shoqërisë mëmë kontrolluese të një sektori,

b) koordinatori i mbikëqyrjes në Republikën e Shqipërisë ose në një Shtet Anëtar, i

përcaktuar në përputhje me nenin 12 të këtij ligji, nëse është i ndryshëm nga autoritetet e përmendura në shkronjën “a” të kësaj pike;

c) sipas rastit, autoritete të tjera kompetente që vlerësohen si të tilla nga autoritetet e përmendura në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike.

20. “Transaksion brenda grupit” nënkupton të gjitha transaksionet përmes të cilave, subjektet e mbikëqyrura në një konglomerat financiar mbështeten, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, tek shoqëri të tjera në të njëjtin grup, ose te një person fizik ose juridik me lidhje të ngushta me personat në këtë grup, për përmbushjen e një detyrimi, kontraktual ose jo, dhe pavarësisht nëse ka si objekt kryerjen e një pagese.

21. “Përqendrim i rrezikut” nënkupton të gjitha ekspozimet ndaj rreziqeve, të cilat potencialisht mund të shkaktojnë një humbje që mund të jetë mjaftueshëm e rëndësishme për të vënë në rrezik aftësinë paguese, ose pozicionin financiar në përgjithësi, të subjekteve të mbikëqyrura në një konglomerat financiar, pavarësisht nëse këto ekspozime janë shkaktuar nga rreziku i kundërpartisë/ rreziku i kredisë, rreziku i investimit, rreziku i sigurimit, rreziku i tregut, rreziqe të tjera, ose nga një kombinim apo ndërthurje e këtyre rreziqeve.

22. “Fondet e veta” nënkupton kapitalin rregullator të përcaktuar dhe të llogaritur sipas legjislacionit përkatës në secilin sektor financiar.

23. “Legjislacion i posaçëm” ose “rregullat sektoriale” nënkupton, sipas rastit, të gjithë kuadrin ligjor dhe nënligjor të zbatueshëm nga Banka e Shqipërisë ose Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për mbikëqyrjen e subjekteve përkatëse që janë në kompetencën mbikëqyrëse të secilit prej këtyre autoriteteve, përfshirë ligjet, aktet nënligjore, rregulloret, udhëzimet dhe çdo akt tjetër të miratuar në zbatim të tyre.

24. “Shtet anëtar” nënkupton një shtet që është anëtar i Bashkimit Evropian ose një shtet tjetër që i përket Zonës Ekonomike Evropiane.

25. “Vendi i tretë” nënkupton një shtet të huaj që nuk është Shtet Anëtar.

26. “Koordinator” nënkupton autoritetin mbikëqyrës përkatës, përgjegjës për ushtrimin e mbikëqyrjes shtesë të subjekteve të mbikëqyrura në një konglomerat financiar.

Neni 3

Pragjet për identifikimin e një konglomerati financiar

1. Për të përcaktuar nëse veprimtaritë e një grupi ushtrohen kryesisht në sektorin financiar, sipas kuptimit të nenit 2, pika 16, shkronja “b”, nënpika “i”, raporti ndërmjet totalit të aktiveve të subjekteve të mbikëqyrura dhe të pambikëqyrura të grupit në sektorin financiar dhe totalit të aktiveve të grupit në tërësi, duhet të jetë mbi 40%.

2. Për të përcaktuar nëse veprimtaritë në sektorë të ndryshëm financiarë janë të rëndësishme në kontekstin e nenit 2, pika 16, shkronja “a”, nënpika “iii”, ose pika 16, shkronja “b”, nënpika “iii”, për secilin sektor financiar llogaritet mesatarja e: (i) raportit ndërmjet totalit të aktiveve të tregut përkatës dhe totalit të aktiveve të të gjitha subjekteve të grupit që bëjnë pjesë në sektorin financiar; dhe (ii) raportit ndërmjet kërkesave për kapital (për sektorin bankar dhe të shërbimeve të investimeve) ose të aftësisë paguese (për sektorin e sigurimeve dhe risigurimeve) të sektorit përkatës dhe totalit të kërkesave për kapital ose të aftësisë paguese të të gjitha subjekteve të grupit në sektorin financiar. Kur kjo mesatare tejkalon 10%, sektori përkatës konsiderohet si i rëndësishëm.

a) Për qëllimet e këtij ligji, termi “kërkesa për kapital” përfshin, sipas rastit, kërkesat për aftësi paguese të përcaktuara në legjislacionin e sigurimeve dhe risigurimeve.

b) Për qëllimet e këtij ligji, sektori financiar më i vogël në një konglomerat financiar është sektori me mesataren më të ulët, ndërsa sektori financiar më i rëndësishëm është sektori me mesataren më të lartë. Për të llogaritur vlerën mesatare dhe për të përcaktuar sektorët financiarë më të vegjël dhe më të rëndësishëm, sektori i institucioneve të kreditit dhe sektori i shërbimeve të investimit merren në konsideratë së bashku.

c) Shoqëritë administruese përfshihen në sektorin financiar në të cilin bëjnë pjesë brenda grupit. Nëse nuk bëjnë pjesë vetëm në një sektor financiar brenda grupit, ato përfshihen në sektorin financiar më të vogël.

d) Shoqëritë administruese të fondeve të investimeve alternative përfshihen në sektorin financiar në të cilin bëjnë pjesë brenda grupit. Nëse nuk bëjnë pjesë ekskluzivisht në një sektor financiar brenda grupit, ato përfshihen në sektorin financiar më të vogël.

3. Veprimtaritë ndërsektoriale konsiderohen gjithashtu se janë të rëndësishme në kontekstin e nenit 2, pika 16, shkronja “a”, nënpika “iii”, ose pika 16, shkronja “b”, nënpika “iii”, nëse totali aktiveve të tregut financiar më të vogël në grup është më i lartë se ekuivalenti në lekë shqiptare i 6 miliardë eurove.

4. Nëse grupi nuk e arrin pragun e përmendur në pikën 2 të këtij neni, autoritetet mbikëqyrëse përkatëse, përmes një marrëveshjeje të përbashkët, mund të vendosin të mos e konsiderojnë grupin si konglomerat financiar. Gjithashtu, ato mund të vendosin të mos i zbatojnë dispozitat e nenit 7, 8 ose 9 të këtij ligji nëse gjykojnë se përfshirja e grupit në objektin e këtij ligji, apo zbatimi i këtyre dispozitave, nuk është i nevojshëm ose do të ishte i papërshtatshëm apo çorientues lidhur me objektivat e mbikëqyrjes shtesë. Vendimet e marra në përputhje me këtë pikë bëhen publike nga autoritetet mbikëqyrëse, përveç rasteve kur rrethanat e posaçme kërkojnë konfidencialitet.

5. Nëse grupi arrin pragun e përmendur në pikën 2 të këtij neni, por tregu më i vogël financiar nuk e tejkalon vlerën e ekuivalentit në lekë shqiptare të 6 miliardë eurove, autoritetet mbikëqyrëse përkatëse, përmes një marrëveshjeje të përbashkët, mund të vendosin të mos e konsiderojnë grupin si një konglomerat financiar. Gjithashtu, ato mund të vendosin të mos i zbatojnë dispozitat e nenit 7, 8 ose 9 të këtij ligji, nëse gjykojnë se përfshirja e grupit në objektin e këtij ligji, apo zbatimi i këtyre dispozitave, nuk është i nevojshëm ose do të ishte i papërshtatshëm apo çorientues lidhur me objektivat e mbikëqyrjes shtesë. Vendimet e marra në përputhje me këtë pikë, bëhen publike nga autoritetet mbikëqyrëse, përveç rasteve kur rrethanat e posaçme kërkojnë konfidencialitet.

6. Përmes një marrëveshjeje të përbashkët, për zbatimin e pikave 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, autoritetet mbikëqyrëse përkatëse mund:

a) të përjashtojnë një subjekt kur përllogarisin raportet në përqindje, në rastet e përmendura në nenin 6, pika 5, përveçse kur subjekti është zhvendosur nga Republika e Shqipërisë në një vend të tretë dhe ekzistojnë prova që tregojnë se subjekti e ka ndryshuar vendndodhjen për të shmangur rregullimin nga ky ligj;

b) të marrin në konsideratë pajtueshmërinë me pragjet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni për tri vite të njëpasnjëshme, me qëllimin për të shmangur ndryshimet e papritura të regjimit, si dhe të mos e marrin në konsideratë pajtueshmërinë me pragjet nëse ka ndryshime të rëndësishme në strukturën e grupit ;

c) të përjashtojnë një ose disa pjesëmarrje në sektorin më të vogël, nëse këto pjesëmarrje janë vendimtare për identifikimin e një konglomerati financiar dhe paraqesin bashkërisht një interes të papërfillshëm lidhur me objektivat e mbikëqyrjes shtesë.

7. Kur një konglomerat financiar është identifikuar në përputhje me pikat 1, 2, 3 dhe 4 të

këtij neni, çdo vendim për të mos e trajtuar atë si një konglomerat financiar, apo për të mos zbatuar ndaj tij dispozitat e neneve 7, 8 ose 9 të këtij ligji, mund të merret vetëm me propozim të koordinatorit të caktuar për atë konglomerat financiar. Ky propozim paraqitet për shqyrtim nga autoritetet mbikëqyrëse përkatëse dhe vendimi përfundimtar merret me marrëveshje të përbashkët ndërmjet tyre.

8. Për qëllimet e zbatimit të pikave 1 dhe 2 të këtij neni, autoritetet mbikëqyrëse përkatëse, në rrethana të posaçme dhe me marrëveshje të përbashkët, mund të zëvendësojnë kriterin e bazuar në totalin e aktiveve, me një ose disa nga parametrat e mëposhtëm, ose të shtojnë një ose disa prej tyre, nëse vlerësojnë se janë veçanërisht të rëndësishëm për realizimin e objektivave të mbikëqyrjes shtesë sipas këtij ligji:

- a) struktura e të ardhurave;
- b) veprimtaritë jashtë bilancit;
- c) totali i aktiveve nën administrim.

9. Për zbatimin e pikave 1 dhe 2 të këtij neni, në rast se raportet e përmendura në këto pika, bien përkatësisht nën nivelin 40% dhe 10% për një konglomerat financiar që tashmë i nënshtrohet mbikëqyrjes shtesë, gjatë një periudhe trevjeçare pasuese do të zbatohen përqindje më të ulëta, përkatësisht 35% dhe 8%, me qëllim shmangien e kalimeve të menjëhershme në regjime të ndryshme mbikëqyrjeje.

Në mënyrë të ngjashme, për zbatimin e pikës 3 të këtij neni, nëse totali i aktiveve të tregut financiar më të vogël në grup bie nën vlerën e ekuivalentit në lekë shqiptare të 6 miliardë eurove për një konglomerat financiar që tashmë është subjekt i mbikëqyrjes shtesë, do të zbatohet, për një periudhë trevjeçare pasuese, një prag më i ulët se ekuivalenti në lekë shqiptare i 5 miliardë eurove. Gjatë kësaj periudhe trevjeçare, koordinatori, me dakordësinë e autoriteteve mbikëqyrëse përkatëse, mund të vendosë moszbatimin e përkohshëm të përqindjeve ose pragjeve të ulura të parashikuara në këtë pikë.

10. Përlllogaritjet e përmendura në këtë nen lidhur me totalin e aktiveve, kryhen mbi bazën e shumës së agreguar të aktiveve të subjekteve të grupit, sipas pasqyrave të tyre financiare vjetore. Për këtë qëllim, personat në të cilat grupi zotëron pjesëmarrje përfshihen në masën që i korrespondon pjesës proporcionale të zotëruar nga grupi në totalin e aktiveve të tyre. Kur janë të disponueshme pasqyra të konsoliduara, ato përdoren në vend të pasqyrave të veçanta të agreguara.

11. Kërkesat për kapital dhe të aftësisë paguese, të përmendura në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, përlllogariten në përputhje me rregullat sektoriale përkatëse.

12. Autoritetet mbikëqyrëse mund të marrin në konsideratë udhëzimet e nxjerra nga Komiteti i Përbashkët i përcaktuar në nenin 10 të këtij ligji, në fushën e mbikëqyrjes ndërsektoriale dhe të konglomerateve financiare, për të siguruar zbatimin e njëtrajtshëm dhe të harmonizuar të praktikave mbikëqyrëse.

13. Autoritetet mbikëqyrëse rishikojnë periodikisht, të paktën një herë në vit, përjashtimet nga zbatimi i mbikëqyrjes shtesë, si dhe rivlerësojnë treguesit sasiorë të parashikuar në këtë nen dhe vlerësimet e bazuara në rrezik, të zbatuara ndaj grupeve financiare.

14. Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miratojnë udhëzime të përbashkëta në lidhje me pragjet dhe përcaktimin e sektorëve të rëndësishëm financiarë, për zbatimin e këtij neni

Neni 4

Identifikimi i konglomeratit financiar

1. Autoritetet mbikëqyrëse që kanë licencuar subjektet e mbikëqyrura identifikojnë, bazuar në nenet 2, 3 dhe 5 të këtij ligji, çdo grup që përfshihet në objektin e këtij ligji. Për këtë qëllim:

a) autoritetet mbikëqyrëse në Shqipëri dhe autoritetet e tjera mbikëqyrëse, të cilat kanë licencuar subjektet e mbikëqyrura në grup, bashkëpunojnë ngushtësisht,

b) nëse një autoritet mbikëqyrës në Shqipëri gjykon se një subjekt i mbikëqyrur, i licencuar në Shqipëri, është anëtar i një grupi që mund të jetë konglomerat financiar dhe që nuk është identifikuar ende në përputhje me këtë ligj, ai njofton/komunikon pikëpamjen e tij:

- i. autoriteteve të tjera mbikëqyrëse në Shqipëri;
- ii. autoriteteve të tjera mbikëqyrëse të Vendeve Anëtare përkatëse që kanë licencuar subjektin e mbikëqyrur brenda grupit, dhe
- iii. Komitetit të Përbashkët të përcaktuar në nenin 10 të këtij ligji.

2. Koordinatori i caktuar në përputhje me nenin 12 të këtij ligji informon shoqërinë mëmë në krye të grupit, ose, në mungesë të saj, subjektin e mbikëqyrur që ka totalin më të lartë të aktiveve në sektorin financiar më të rëndësishëm të grupit, lidhur me faktin se grupi është identifikuar si një konglomerat financiar dhe lidhur me caktimin e tij si koordinator. Koordinatori informon gjithashtu autoritetet mbikëqyrëse që kanë licencuar subjektet e mbikëqyrura të përfshira në grup dhe autoritetet kompetente të shtetit anëtar ku ka selinë shoqëria financiare zotëruese e përzier, sipas rastit, si dhe Komitetin e Përbashkët të përcaktuar në nenin 10 të këtij ligji.

3. Autoritetet mbikëqyrëse publikojnë dhe përditësojnë në faqet e tyre të internetit, listën e konglomerateve financiare të përcaktuara në përputhje me nenin 2, pika 16 të këtij ligji.

4. Emri i çdo subjekti të mbikëqyrur që është pjesë e një konglomerati financiar regjistrohet në një listë, e cila publikohet dhe përditësohet në faqet e internetit të autoriteteve mbikëqyrëse.

5. Kur koordinatori vlerëson se nuk përmbushen më kërkesat për ushtrimin e mbikëqyrjes shtesë të një konglomerati financiar në përputhje me këtë Ligj, ai njofton për këtë, autoritetet e tjera mbikëqyrëse përkatëse të përmendura në pikën 1 të këtij neni, të cilat kanë marrë pjesë në arritjen e një vendimi të përbashkët mbi ekzistencën e konglomeratit financiar.

6. Autoritetet mbikëqyrëse të përmendura në pikën 5 të këtij neni marrin vendim të përbashkët për heqjen e statusit të konglomeratit financiar, nëse nuk përmbushen më kërkesat e këtij Ligji për identifikimin e një konglomerati financiar.

7. Koordinatori i dorëzon vendimin e përmendur në pikën 6 të këtij neni anëtarit të grupit që udhëheq konglomeratin financiar, i cili, brenda tetë ditëve nga marrja e vendimit, njofton të gjithë personat që janë pjesë e atij konglomerati financiar.

8. Anëtari i grupit që udhëheq konglomeratin financiar njofton me shkrim koordinatorin se janë ndërprerë kërkesat për ekzistencën e konglomeratit financiar, dhe këtë e bën brenda 30 ditëve nga ndërprerja e këtyre kërkesave për identifikimin e konglomeratit financiar.

KREU II MBIKËQYRJA SHITESË

PJESA I OBJEKTI

Neni 5

Objekti i mbikëqyrjes shtesë së subjekteve të mbikëqyrura

1. Pa cenuar dispozitat për mbikëqyrjen dhe rregullat për secilin sektor, Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, secila më vete dhe, kur është e nevojshme, në bashkëpunim me njëra-tjetrën dhe me autoritetet e tjera kompetente, identifikojnë çdo grup që hyn në fushën e zbatimit të këtij ligji, në të cilin subjekte të mbikëqyrura të licencuara prej tyre zotërojnë pjesëmarrje.

2. Subjektet e mbikëqyrura në vijim janë subjekt i mbikëqyrjes shtesë në nivelin e konglomeratit financiar, në përputhje me nenet 6 deri në 21 të këtij ligji:

a) çdo subjekt i mbikëqyrur që është në krye të një konglomerati dhe ndodhet me seli në Republikën e Shqipërisë;

b) çdo subjekt i mbikëqyrur, shoqëria mëmë e të cilit është një shoqëri financiare zotëruese e përzier e cila ndodhet me seli në Republikën e Shqipërisë ose në një shtet të anëtar;

c) çdo subjekt i mbikëqyrur i lidhur me një subjekt tjetër të tregut financiar nëpërmjet marrëdhënieve si më poshtë:

i) administrim i përbashkët në bazë të një kontrate ose të akteve të tyre themeluese/statuteve;

ii) më shumë se gjysma e anëtarëve të organeve të tyre të administrimit ose të mbikëqyrjes janë të njëjtët persona gjatë vitit financiar dhe deri në datën e përgatitjes së pasqyrave të konsoliduara.

3. Kur një konglomerat financiar përbën një nëngrup të një konglomerati tjetër financiar, i cili plotëson kërkesat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, Autoritetet Mbikëqyrëse mund të zbatojnë dispozitat e neneve 6 deri në 21 të këtij ligji vetëm për subjektet e mbikëqyrura që janë pjesë e atij konglomerati tjetër financiar. Në këto raste, çdo referencë në këtë ligj ndaj termave “grup” dhe “konglomerat financiar” do të kuptohet si referencë ndaj atij konglomerati financiar.

4. Çdo subjekt i mbikëqyrur që nuk është subjekt i mbikëqyrjes shtesë në përputhje me pikën 2 dhe 3 të këtij neni, shoqëria mëmë e të cilit është një subjekt i mbikëqyrur ose një shoqëri financiare zotëruese e përzier që e ka selinë në një vend të tretë, është subjekt i mbikëqyrjes shtesë në nivelin e konglomeratit financiar në masën dhe në mënyrën e parashikuar në nenin 22 të këtij ligji.

5. Kur persona kanë pjesëmarrje ose lidhje të ngushta në një ose disa subjekte të mbikëqyrura, apo ushtrojnë ndikim të konsiderueshëm mbi këto subjekte pa pjesëmarrje ose lidhje të ngushta, përveçse në rastet e përmendura në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij neni, autoritetet mbikëqyrëse përkatëse, përmes një marrëveshje të përbashkët dhe në përputhje me ligjet dhe aktet e tyre rregullatore, përcaktojnë nëse dhe në çfarë mase do të kryhet mbikëqyrja shtesë e subjekteve të mbikëqyrura, njësoj sikur të përbënin një konglomerat financiar.

Për të aplikuar këtë mbikëqyrje shtesë, të paktën një nga subjektet duhet të jetë një subjekt i mbikëqyrur, si dhe duhet të përmbushen kushtet e parashtruara në nenin 2, pika 16, shkronja “a”, nënpika “ii”, ose pika 16, shkronja “b”, nënpika “ii” dhe në nenin 2, pika 16, shkronja “a”, nënpika “iii”, ose pika 16, shkronja “b”, nënpika “iii”. Autoritetet mbikëqyrëse përkatëse e marrin vendimin e tyre duke marrë në konsideratë objektivat e mbikëqyrjes shtesë, të parashikuar në këtë ligj.

6. Me qëllim zbatimit të paragrafit të parë të pikës 5 të këtij neni për “grupet e bashkëpunimit ekonomik” të rregulluara sipas ligjit të posaçëm për shoqëritë e bashkëpunimit ekonomik, autoritetet mbikëqyrëse duhet të marrin në konsideratë angazhimin financiar publik të këtyre grupeve lidhur me subjektet e tjera financiare.

7. Pa cenuar kërkesat e nenit 17 të këtij ligji, ushtrimi i mbikëqyrjes shtesë në nivelin e konglomeratit financiar nuk nënkupton në asnjë mënyrë se autoritetet mbikëqyrëse duhet të luajnë një rol mbikëqyrës në lidhje me shoqëritë financiare zotëruese të përziera, subjektet e rregulluara të vendeve të treta në një konglomerat financiar, apo subjektet e parregulluara në një konglomerat financiar, mbi baza individuale.

PJESA II POZICIONI FINANCIAR

Neni 6 Mjaftueshmëria e kapitalit

1. Pa cenuar rregullat sektoriale të zbatueshme për secilin treg financiar, mbikëqyrja shtesë e mjaftueshmërisë së kapitalit të subjekteve të mbikëqyrura në një konglomerat financiar, ushtrohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 9, pikat 2 deri në 5 dhe në Aneksin I të këtij ligji.

2. Subjektet e mbikëqyrura në një konglomerat financiar garantojnë disponueshmërinë e fondeve të veta, në nivelin e konglomeratit financiar, në një vlerë të paktën të barabartë me kërkesat për mjaftueshmërinë e kapitalit, të përlllogaritur në përputhje me Aneksin I të këtij ligji. Subjektet e mbikëqyrura duhet të kenë politika të përshtatshme për mjaftueshmërinë e kapitalit, në nivelin e konglomeratit financiar.

Kërkesat e përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni janë subjekt i një vlerësimi të përgjithshëm mbikëqyrës nga koordinatori, në përputhje me Pjesën III të këtij kreu. Koordinatori sigurohet që përlllogaritja e përmendur në nënparagrafin e parë të kësaj pike, të realizohet të paktën një herë në vit, ose nga subjektet e mbikëqyrura ose nga shoqëria financiare zotëruese e përzier. Rezultatet e përlllogaritjes dhe të dhënat përkatëse për përlllogaritjen i dorëzohen koordinatorit nga subjekti i mbikëqyrur, i cili është në krye të konglomeratit financiar, ose, në rastet kur në krye të konglomeratit financiar nuk ka një subjekt të mbikëqyrur, nga shoqëria financiare zotëruese e përzier ose nga subjekti i mbikëqyrur në konglomeratin financiar të identifikuar nga koordinatori pas konsultimit me autoritetet e tjera përkatëse mbikëqyrëse dhe me konglomeratin financiar.

3. Me qëllim përlllogaritjen e kërkesave për mjaftueshmërinë e kapitalit, të përmendura në nënparagrafin e parë të pikës 2 të këtij neni, subjektet e mëposhtme përfshihen në objektin e mbikëqyrjes shtesë në përputhje me Aneksin I të këtij ligji:

- a) një institucion krediti, një institucion financiar, ose një shoqëri e shërbimeve ndihmëse;
- b) një shoqëri sigurimi, një shoqëri risigurimi, ose një shoqëri zotëruese sigurimi;
- c) një shoqëri komisionere;
- d) një shoqëri financiare zotëruese e përzier.

4. Në rastet kur përlllogariten kërkesat shtesë për mjaftueshmërinë e kapitalit lidhur me një konglomerat financiar nëpërmjet zbatimit të metodës 1 (Konsolidimi kontabël), të përmendur në Aneksin I të këtij ligji, kërkesat për fondet e veta dhe për aftësinë paguese, për subjektet pjesë e grupit, përlllogariten duke zbatuar rregullat përkatëse sektoriale për formën dhe shtrirjen e konsolidimit për institucionet e kreditit dhe për shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit në Republikën e Shqipërisë.

Në rastet kur zbatohet metoda 2 (Zbritja dhe agregimi), e përmendur në Aneksin I të këtij ligji, përlllogaritja merr në konsideratë pjesën e kapitalit të nënshkruar që zotërohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga shoqëria mëmë ose nga shoqëria që zotëron pjesëmarrje në një

tjetër shoqëri të grupit.

5. Koordinatori mund të vendosë që të mos përfshijë në objektin e mbikëqyrjes shtesë, një subjekt të caktuar kur përlogarit kërkesat shtesë për mjaftueshmërinë e kapitalit, në rastet e mëposhtme:

a) nëse subjekti ndodhet në një vend të tretë ku ka pengesa ligjore për transferimin e informacionit të nevojshëm, pa cenuar rregullat e tyre sektoriale lidhur me detyrimin e autoriteteve mbikëqyrëse për të refuzuar licencimin në rastet kur pengohet ushtrimi i funksioneve të tyre mbikëqyrëse;

b) nëse subjekti paraqet një interes të papërfillshëm lidhur me objektivat e mbikëqyrjes shtesë së subjekteve të mbikëqyrura në konglomeratin financiar;

c) nëse përfshirja e subjektit do të ishte e papërshtatshme ose çorientuese lidhur me objektivat e mbikëqyrjes shtesë.

Megjithatë, nëse ekzistojnë disa subjekte që mund të përjashtohen sipas shkronjës “b”, ato duhet të përfshihen kur së bashku paraqesin një interes të konsiderueshëm.

Në rastin e përmendur në shkronjën “c” koordinatori konsultohet me autoritetet mbikëqyrëse përpara marrjes së një vendimi, me përjashtim të rasteve urgjente.

Kur koordinatori nuk përfshin një subjekt të mbikëqyrur në përputhje me një nga rastet e parashikuara në shkronjat “b” dhe “c”, autoritetet mbikëqyrëse mund t’i kërkojnë subjektit në krye të konglomeratit financiar që t’i japë informacione të cilat mund të lehtësojnë mbikëqyrjen e subjektit të mbikëqyrur.

Neni 7 **Përqendrimi i rrezikut**

1. Pa cenuar rregullat sektoriale, mbikëqyrja shtesë e përqendrimit të rrezikut të subjekteve të mbikëqyrura në një konglomerat financiar, ushtrohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 9, pikat 2 deri në 4 dhe në Aneksin II të këtij ligji.

2. Subjektet e mbikëqyrura ose shoqëritë financiare zotëruese të përziera duhet t’i raportojnë koordinatorit rregullisht, dhe të paktën çdo vit, çdo nivel të konsiderueshëm të përqendrimit të rrezikut në nivelin e konglomeratit financiar, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë nen dhe në Aneksin II të këtij ligji. Informacionet e nevojshme i dorëzohen koordinatorit nga subjekti i mbikëqyrur, i cili është në krye të konglomeratit financiar, ose, në rastet kur në krye të konglomeratit financiar nuk ka një subjekt të mbikëqyrur, nga shoqëria financiare zotëruese e përzier ose nga subjekti i mbikëqyrur në konglomeratin financiar të identifikuar nga koordinatori pas konsultimit me autoritetet mbikëqyrëse dhe me konglomeratin financiar.

Këto përqendrime të rrezikut janë objekt i vlerësimit të përgjithshëm mbikëqyrës nga koordinatori në përputhje me Pjesën III të këtij kreu.

3. Autoritetet mbikëqyrëse mund të vendosin kufij sasiore ose të miratojnë masa të tjera mbikëqyrëse të cilat do të arrinin objektivat e mbikëqyrjes shtesë lidhur me çdo përqendrim të rrezikut në nivelin e konglomeratit financiar.

4. Kur një konglomerat financiar drejtohet nga një shoqëri financiare zotëruese e përzier, atëherë rregullat sektoriale për përqendrimin e rrezikut të tregut më të rëndësishëm financiar në konglomeratin financiar, nëse ka, do të zbatohen për atë treg në tërësi, duke përfshirë shoqërinë financiare zotëruese të përzier.

5. Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miratojnë udhëzime të

përbashkëta në lidhje me mbikëqyrjen shtesë të përqendrimit të rrezikut në nivelin e konglomeratit financiar, në zbatim të këtij neni.

Neni 8

Transaksionet brenda grupit

1. Pa cenuar rregullat sektoriale të zbatueshme për secilin treg financiar, mbikëqyrja shtesë e transaksioneve brenda grupit të subjekteve të mbikëqyrura në një konglomerat financiar, ushtrohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 9, pikat 2 deri në 4 dhe në Aneksin II të këtij ligji.

2. Subjektet e mbikëqyrura ose shoqëritë financiare zotëruese të përziera i raportojnë koordinatorit rregullisht, dhe të paktën çdo vit, të gjitha transaksionet e rëndësishme brenda grupit të subjekteve të mbikëqyrura në një konglomerat financiar, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë nen dhe në Aneksin II të këtij ligji. Një transaksion brenda grupit konsiderohet i rëndësishëm, nëse shuma e tij tejkalon të paktën 5% të shumës totale të kërkesave për mjaftueshmërinë e kapitalit në nivelin e konglomeratit financiar, me përjashtim të rasteve kur autoriteti mbikëqyrës përkatës në bashkëpunim me koordinatorin, vendosin ndryshe.

Informacionet e nevojshme i dorëzohen koordinatorit nga subjekti i mbikëqyrur i cili është në krye të konglomeratit financiar, ose, në rastet kur në krye të konglomeratit financiar nuk ka një subjekt të mbikëqyrur, nga shoqëria financiare zotëruese e përzier ose nga subjekti i mbikëqyrur në konglomeratin financiar të identifikuar nga koordinatori pas konsultimit me autoritetet mbikëqyrëse dhe me konglomeratin financiar.

3. Autoritetet mbikëqyrëse mund të vendosin kufij sasiorë dhe kërkesa cilësore, ose të ndërmarrin masa të tjera mbikëqyrëse të cilat do të arrinin objektivat e mbikëqyrjes shtesë lidhur me transaksionet brenda grupit të subjekteve të mbikëqyrura në një konglomerat financiar.

4. Kur një konglomerat financiar drejtohet nga një shoqëri financiare zotëruese e përzier, atëherë rregullat sektoriale për transaksionet brenda grupit të tregut më të rëndësishëm financiar në konglomeratin financiar do të zbatohen për atë treg në tërësi, duke përfshirë shoqërinë financiare zotëruese të përzier.

5. Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miratojnë udhëzime të përbashkëta në lidhje me mbikëqyrjen shtesë të transaksioneve brenda grupit, në zbatim të këtij neni

Neni 9

Mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe proceset e administrimit të rrezikut

1. Subjektet e mbikëqyrura duhet të kenë, në nivelin e konglomeratit financiar, procese të përshtatshme të administrimit të rrezikut dhe mekanizma të përshtatshëm të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë procedura të qëndrueshme administrative dhe kontabël.

2. Proceset e administrimit të rrezikut përfshijnë:

a) qeverisje dhe administrim të shëndoshë, duke përfshirë miratimin dhe rishikimin periodik të strategjive dhe të politikave nga organet drejtuese në nivelin e konglomeratit financiar, në lidhje me të gjitha rreziqet që ato marrin përsipër;

b) politika të përshtatshme për mjaftueshmërinë e kapitalit me qëllimin për të parashikuar ndikimin e strategjisë së biznesit të profilit të rrezikut dhe respektimin e kërkesave për kapitalin, siç përcaktohet në nenin 6 dhe Aneksin I të këtij ligji;

c) procedura të përshtatshme për të garantuar se sistemet e monitorimit të rrezikut janë integruar siç duhet në strukturën e organizimit të tyre dhe se janë marrë të gjitha masat për t'u siguruar se sistemet e zbatuara në të gjitha shoqëritë e përfshira në objektin e mbikëqyrjes shtesë janë të përshtatshme, me qëllim që rreziqet të mund të maten, monitorohen dhe kontrollohen në nivelin e konglomeratit financiar;

d) masa të miratuara për të kontribuar dhe për të zhvilluar, sipas nevojës, marrëveshje dhe plane të përshtatshme për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme. Këto masa përditësohen rregullisht.

3. Mekanizmat e kontrollit të brendshëm përfshijnë:

a) mekanizma të përshtatshëm lidhur me mjaftueshmërinë e kapitalit për të identifikuar dhe matur të gjitha rreziqet materiale të hasura, si dhe për të përcaktuar një lidhje të përshtatshme ndërmjet fondeve të veta dhe rreziqeve;

b) procedura të qëndrueshme raportimi dhe kontabël për të identifikuar, monitoruar dhe kontrolluar transaksionet brenda grupit dhe përqendrimin e rrezikut.

4. Shoqëritë e përfshira në objektin e mbikëqyrjes shtesë sipas nenit 5 të këtij ligji, duhet të kenë mekanizma të përshtatshëm të kontrollit të brendshëm për të gjeneruar të dhëna dhe informacione me rëndësi për qëllimet e mbikëqyrjes shtesë.

Subjektet e mbikëqyrura, në nivelin e konglomeratit financiar, pajisin çdo vit, autoritetet mbikëqyrëse me detaje mbi strukturën e tyre ligjore, si dhe mbi strukturën e qeverisjes dhe atë organizative, duke përfshirë për të gjitha subjektet e mbikëqyrura, shoqëritë e kontrolluara të parregulluara dhe degët e tyre.

Subjektet e mbikëqyrura publikojnë çdo vit, në nivelin e konglomeratit financiar, një përshkrim të strukturës së tyre ligjore, si dhe të strukturës së qeverisjes dhe asaj organizative.

5. Proceset dhe mekanizmat e përmendur në pikat 1 deri në 4 të këtij neni janë subjekt i vlerësimit të përgjithshëm mbikëqyrës nga koordinatori.

6. Autoritetet mbikëqyrëse përkatëse sigurojnë që mbikëqyrja shtesë e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe e proceseve të administrimit të rrezikut të kryhet në mënyrë të koordinuar dhe të harmonizuar me proceset e zakonshme të rishikimit mbikëqyrës të zbatuara ndaj subjekteve të mbikëqyrura, sipas legjislacionit dhe rregullave përkatëse sektoriale.

7. Në rast se zbatimi i kërkesave të këtij neni ndikohet nga kufizimet e legjislacionit shqiptar që rregullon veprimtarinë e shoqërive tregtare, autoritetet mbikëqyrëse marrin masa për të siguruar që informacioni i nevojshëm të mund të sigurohet dhe vlerësohet në mënyrë efektive për qëllime mbikëqyrjeje.

8. Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miratojnë udhëzime të përbashkëta në lidhje me proceset e administrimit të rrezikut dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm në nivelin e një konglomerati financiar, me qëllim harmonizimin e praktikave mbikëqyrëse në këto fusha.

PJESA III

MASAT PËR TË LEHTËSUAR MBIKËQYRJEN SHITESË DHE KOMPETENCAT E KOMITETIT TË PËRBASHKËT

Neni 10

Ndërveprimi institucional

1. Autoritetet mbikëqyrëse bashkëpunojnë ndërmjet tyre dhe me autoritete homologe

ndërkombëtare për të garantuar një mbikëqyrje të harmonizuar ndërsektoriale dhe ndërkufitare të konglomerateve financiare.

2. Autoritetet mbikëqyrëse zhvillojnë udhëzime të përbashkëta mbi mënyrën e kryerjes së vlerësimeve të bazuara në rrezik ndaj konglomerateve financiare. Në veçanti, këto udhëzime sigurojnë që vlerësimet të përfshijnë mjete të përshtatshme për identifikimin dhe vlerësimin e grupeve të rreziqeve me të cilat përballen konglomeratet financiare.

3. Autoritetet mbikëqyrëse zhvillojnë gjithashtu udhëzime të përbashkëta që synojnë zhvillimin e praktikave të harmonizuara të mbikëqyrjes, me qëllim që mbikëqyrja shtesë ndaj shoqërive financiare kontrolluese zotëruese të përziera të plotësojë në mënyrë të përshtatshme mbikëqyrjen në nivel grupi sipas rregullave sektoriale për tregun bankar, atë të sigurimeve ose të shërbimeve të investimeve. Këto udhëzime synojnë të përfshijnë në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha rreziqet dhe të shmangin mbivendosjen e panevojshme të detyrimeve prudenciale dhe mbikëqyrëse.

4. Për qëllime të përafrimit me *acquis-in* e Bashkimit Evropian, autoritetet mbikëqyrëse marrin në konsideratë, në mënyrë progresive, zhvillimet institucionale dhe praktikat e Komitetit të Përbashkët të Autoriteteve Evropiane të Mbikëqyrjes (në vijim: **Komiteti i Përbashkët**), i cili është organ bashkërendues ndërsektorial i themeluar në bazë të nenit 54 të Rregulloreve (BE) nr. 1093/2010, nr. 1094/2010 dhe nr. 1095/2010 të Bashkimit Evropian, ndërmjet Autoritetit Bankar Evropian (EBA), Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) dhe Autoritetit Evropian të Titujve dhe Tregjeve (ESMA), që synojnë koherencën e mbikëqyrjes financiare në nivel ndërsektorial dhe ndërkombëtar.

Neni 11

Prova e rezistencës (Stress testing)

1. Koordinatori duhet të garantojë kryerjen, në mënyrë të përshtatshme dhe periodike, të provës së rezistencës së konglomerateve financiare dhe autoritetet mbikëqyrëse kanë detyrimin të bashkëpunojnë plotësisht me koordinatorin për këtë qëllim.

2. Autoritetet mbikëqyrëse mund të organizojnë, në mënyrë periodike dhe të koordinuar, prova të rezistencës që synojnë vlerësimin e aftësisë së konglomerateve financiare për t'u përballur me rreziqe sistemike ose ndërsektoriale.

3. Për qëllimet e përafrimit me praktikat e Bashkimit Evropian, autoritetet mbikëqyrëse marrin në konsideratë zhvillimet e fundit në nivel ndërkombëtar dhe rajonal që lidhen me vlerësimin makroprudencial të konglomerateve financiare dhe mund të përdorin ose përshtatin parametrat dhe skenarët përkatës për identifikimin e rreziqeve të përbashkëta. Koordinatori i komunikon Komitetit të Përbashkët, rezultatet e testeve të stresit.

4. Autoriteti mbikëqyrës përkatës i Republikës së Shqipërisë mund të vendosë, ndaj një shoqërie zotëruese financiare të përzier ose ndaj një personi në një konglomerat financiar që nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në nenet 5 deri 11 të këtij ligji, dhe për të cilin aftësia paguese ose mjaftueshmëria e kapitalit është e rrezikuar ose ku transaksionet brenda grupit ose përqendrimet e rrezikut paraqesin kërcënim për pozicionin financiar, masa për të korrigjuar pozicionin financiar të atij konglomerati financiar në përputhje me rregullat sektoriale.

5. Koordinatori vendos masat mbikëqyrëse ndaj shoqërisë zotëruese financiare të përzier, ndërsa autoriteti mbikëqyrës përkatës vendos masat mbikëqyrëse ndaj një subjekti të mbikëqyrur, nëse bëhet fjalë për një konglomerat financiar që nuk udhëhiqet nga shoqëria zotëruese financiare e përzier.

6. Koordinator, autoritetet mbikëqyrëse përkatëse dhe autoritetet e tjera kompetente bashkëpunojnë dhe koordinojnë ndërmjet tyre zbatimin e masave mbikëqyrëse, në mënyrë që të sigurohet qasje e harmonizuar dhe efektive ndaj konglomeratit financiar.

Neni 12

Koordinatori për ushtrimin e mbikëqyrjes shtesë

1. Për të garantuar ushtrimin në mënyrë të koordinuar dhe efektive të mbikëqyrjes shtesë mbi subjektet e mbikëqyrura në një konglomerat financiar, një nga autoritetet mbikëqyrëse përkatëse caktohet si koordinator. Koordinatori është përgjegjës për drejtimin dhe bashkërendimin e mbikëqyrjes shtesë ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse përkatëse, përfshirë edhe ato të shtetit në të cilin ndodhet selia e shoqërisë financiare zotëruese të përzier, nëse kjo ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Identiteti i koordinatorit bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të secilit autoritet mbikëqyrës përkatës. Pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ky informacion i përcillet Komitetit të Përbashkët të Autoriteteve Evropiane të Mbikëqyrjes për publikim në faqen zyrtare të tij, në përputhje me kërkesat e *acquis-it* të BE-së

2. Banka e Shqipërisë do të jetë në rolin e koordinatorit në rastet e mëposhtme:

a) kur konglomerati financiar drejtohet nga institucion krediti i licencuar nga Banka e Shqipërisë;

b) kur konglomerati financiar nuk drejtohet nga një subjekt i mbikëqyrur, dhe shoqëria mëmë e subjektit të mbikëqyrur është shoqëri financiare zotëruese e përzier, nëse subjekti i mbikëqyrur është institucion krediti i licencuar nga Banka e Shqipërisë;

c) kur konglomerati financiar nuk drejtohet nga një subjekt i mbikëqyrur, dhe shoqëria financiare zotëruese e përzier me seli qendrore në Shqipëri është shoqëria mëmë e të paktën dy subjekteve të mbikëqyrura nga sektorë të ndryshëm financiarë, dhe të paktën një nga këto subjekte është licencuar nga Banka e Shqipërisë, dhe të paktën një është licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, kur sektori bankar është sektori financiar më i rëndësishëm në konglomeratin financiar;

ç) kur konglomerati financiar nuk drejtohet nga një subjekt i mbikëqyrur, dhe një shoqëri financiare zotëruese e përzier me seli qendrore në Shqipëri është shoqëri mëmë e të paktën një institucioni krediti që është licencuar nga Banka e Shqipërisë dhe të paktën një subjekti të mbikëqyrur me seli qendrore në një Shtet Anëtar;

d) kur konglomerati financiar nuk drejtohet nga një subjekt i mbikëqyrur, dhe konglomerati financiar drejtohet nga të paktën një shoqëri financiare zotëruese e përzier me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë dhe të paktën një shoqëri financiare zotëruese e përzier me seli qendrore në një Shtet Anëtar, dhe ekziston një subjekt i mbikëqyrur në secilin prej këtyre Shteteve, me kusht që të dy subjektet t'i përkasin sektorit bankar dhe që institucioni i kreditit i licencuar nga Banka e Shqipërisë të ketë vlerën më të madhe të bilancit;

dh) kur konglomerati financiar nuk drejtohet nga një subjekt i mbikëqyrur, dhe konglomerati financiar drejtohet nga të paktën një shoqëri financiare zotëruese e përzier me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë dhe të paktën një shoqëri financiare zotëruese e përzier me seli qendrore në një Shtet Anëtar, dhe ekziston një subjekt i mbikëqyrur në secilin prej këtyre Shteteve, me kusht që subjekti i rregulluar me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë të jetë institucion krediti i licencuar nga Banka e Shqipërisë dhe ku sektori bankar është sektori financiar më i rëndësishëm;

e) kur konglomerati financiar nuk drejtohet nga një subjekt i mbikëqyrur, dhe të paktën një subjekt i mbikëqyrur me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë dhe të paktën një subjekt i mbikëqyrur me seli qendrore në një Shtet Anëtar është në varësi të së njëjtës shoqëri financiare zotëruese të përzier, dhe një nga këto subjekte është institucion krediti i cili është licencuar nga Banka e Shqipërisë;

ë) kur konglomerati financiar nuk drejtohet nga një subjekt i mbikëqyrur, dhe të paktën një subjekt i mbikëqyrur me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë dhe të paktën një subjekt i mbikëqyrur me seli qendrore në një Shtet Anëtar është në varësi të së njëjtës shoqëri financiare zotëruese të përzier, me kusht që asnjë nga subjektet e mbikëqyrura të mos jetë licencuar në shtetin në të cilin shoqëria financiare e përzier ka selinë qendrore, dhe institucioni i kreditit i licencuar nga Banka e Shqipërisë është subjekti i mbikëqyrur me vlerën më të madhe të bilancit në sektorin financiar më të rëndësishëm të atij konglomerati financiar;

f) kur konglomerati financiar nuk drejtohet nga një subjekt i mbikëqyrur, dhe të paktën një subjekt i mbikëqyrur me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë dhe të paktën një subjekt i mbikëqyrur me seli qendrore në një Shtet Anëtar është në varësi të së njëjtës shoqëri financiare zotëruese të përzier, dhe asnjë nga subjektet e mbikëqyrura nuk është licencuar në shtetin në të cilin shoqëria financiare zotëruese e përzier ka selinë qendrore, dhe subjekti i mbikëqyrur me vlerën më të madhe të bilancit në sektorin më të rëndësishëm financiar është një institucion krediti i licencuar nga Banka e Shqipërisë;

g) kur konglomerati financiar nuk drejtohet nga një subjekt i mbikëqyrur, dhe konglomerati financiar është grup pa shoqëri mëmë, dhe institucioni i kreditit i licencuar nga Banka e Shqipërisë është subjekti i mbikëqyrur me vlerën më të madhe të bilancit në sektorin më të rëndësishëm financiar; ose

gj) në të gjitha rastet e tjera, kur një konglomerat financiar nuk drejtohet nga një subjekt i mbikëqyrur, dhe një institucion krediti i licencuar nga Banka e Shqipërisë është subjekti i mbikëqyrur me totalin më të madh të bilancit në sektorin më të rëndësishëm financiar.

3. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare do të jetë në rolin e koordinatorit në rastet e mëposhtme:

a) kur konglomerati financiar drejtohet nga një shoqëri e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;

b) kur konglomerati financiar nuk drejtohet nga një subjekt i mbikëqyrur, dhe shoqëria mëmë e subjektit të mbikëqyrur është shoqëri financiare zotëruese e përzier, nëse subjekti i mbikëqyrur është licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;

c) kur konglomerati financiar nuk drejtohet nga një subjekt i mbikëqyrur, dhe shoqëria financiare zotëruese e përzier me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë është shoqëria mëmë e të paktën dy subjekteve të mbikëqyrura nga sektorë të ndryshëm financiarë, dhe të paktën një nga këto subjekte është licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, kur sektori i sigurimeve ose sektori shërbimeve të investimit është sektori financiar më i rëndësishëm në konglomeratin financiar;

ç) kur konglomerati financiar nuk drejtohet nga një subjekt i mbikëqyrur, dhe shoqëria financiare zotëruese e përzier me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë është shoqëria mëmë e të paktën një subjekti të mbikëqyrur me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe/ose të paktën një subjekti të mbikëqyrur me seli qendrore në një Shtet Anëtar;

d) kur konglomerati financiar nuk drejtohet nga një subjekt i mbikëqyrur, dhe konglomerati financiar drejtohet nga të paktën një shoqëri financiare zotëruese e përzier me seli

qendrore në Republikën e Shqipërisë dhe të paktën një shoqëri financiare zotëruese e përzier me seli qendrore në një Shtet Anëtar, dhe ekziston një subjekt i mbikëqyrur në secilin prej këtyre Shteteve, me kusht që ato t'i përkasin të njëjtit sektor financiar dhe subjekti i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të ketë vlerën më të madhe të bilancit;

dh) kur konglomerati financiar nuk drejtohet nga një subjekt i mbikëqyrur, dhe konglomerati financiar drejtohet nga të paktën një shoqëri financiare zotëruese e përzier me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë dhe të paktën një shoqëri financiare zotëruese e përzier me seli qendrore në një Shtet Anëtar, dhe ekziston një subjekt i mbikëqyrur në secilin prej këtyre Shteteve, me kusht që subjekti i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare t'i përkasë sektorit më të rëndësishëm financiar;

e) kur konglomerati financiar nuk drejtohet nga një subjekt i mbikëqyrur, dhe të paktën një subjekt i mbikëqyrur me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë dhe të paktën një subjekt i mbikëqyrur me seli qendrore në një Shtet Anëtar është në varësi të së njëjtës shoqëri financiare të përzier, me kusht që asnjë nga subjektet e mbikëqyrura të mos jetë licencuar në shtetin në të cilin shoqëria financiare zotëruese e përzier ka selinë qendrore, dhe subjekti i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është subjekti i mbikëqyrur me vlerën më të madhe të bilancit në sektorin financiar më të rëndësishëm të atij konglomerati financiar;

ë) kur konglomerati financiar nuk drejtohet nga një subjekt i mbikëqyrur, dhe të paktën një subjekt i mbikëqyrur me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë dhe të paktën një subjekt i mbikëqyrur me seli qendrore në një Shtet Anëtar është në varësi të së njëjtës shoqëri financiare zotëruese të përzier, dhe një nga këto subjekte licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

f) kur konglomerati financiar nuk drejtohet nga një subjekt i mbikëqyrur, dhe të paktën një subjekt i mbikëqyrur me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë dhe të paktën një subjekt i mbikëqyrur me seli qendrore në një Shtet Anëtar është në varësi të së njëjtës shoqëri financiare zotëruese të përzier, dhe asnjë nga subjektet e rregulluara nuk është licencuar në shtetin në të cilin shoqëria financiare zotëruese e përzier ka selinë qendrore, dhe subjekti i mbikëqyrur me vlerën më të madhe të bilancit në sektorin më të rëndësishëm financiar është subjekti i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;

g) kur konglomerati financiar nuk drejtohet nga një subjekt i mbikëqyrur, dhe konglomerati financiar është grup pa shoqëri mëmë, dhe subjekti i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është subjekti i mbikëqyrur me vlerën më të madhe të bilancit në sektorin më të rëndësishëm financiar; ose

gj) në raste të tjera, kur konglomerati financiar nuk drejtohet nga një subjekt i mbikëqyrur, dhe subjekti i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është subjekti i mbikëqyrur me vlerën më të madhe të bilancit në sektorin më të rëndësishëm financiar;

4. Për të siguruar mbikëqyrje të përshtatshme shtesë të subjekteve të mbikëqyrura në një konglomerat financiar, një koordinator i vetëm, përgjegjës për koordinimin dhe ushtrimin e mbikëqyrjes shtesë, emërohet nga autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare përkatëse, duke përfshirë ato të Shtetit Anëtar në të cilin shoqëria financiare zotëruese e përzier ka selinë e saj qendrore dhe të dhënat dhe informacionet mbi koordinatorin e emëruar publikohen në faqen e internetit të Komitetit të Përbashkët.

5. Në raste të veçanta, autoritetet mbikëqyrëse përkatëse, nëpërmjet një marrëveshjeje të përbashkët, mund të heqin dorë nga kriteret e përmendura në pikën 2 ose 3 të këtij neni nëse zbatimi i tyre do të ishte i papërshtatshëm, duke marrë në konsideratë strukturën e konglomeratit dhe rëndësinë relative të veprimtarive të tij në vende të ndryshme, si dhe të caktojnë një tjetër autoritet kompetent në cilësinë e koordinatorit. Në

këto raste, përpara marrjes së vendimit, autoritetet mbikëqyrëse i japin konglomeratit mundësinë që të shprehë mendimin e tij rreth vendimit.

Neni 13

Detyrat e koordinatorit

1. Koordinatori kryen detyrat e mëposhtme, lidhur me mbikëqyrjen shtesë:

a) koordinimin e mbledhjes dhe shpërndarjes së informacioneve përkatëse ose thelbësore, si në kushte normale biznesi, ashtu edhe në situata emergjente, përfshirë shpërndarjen e informacioneve që kanë rëndësi për detyrat mbikëqyrëse të autoriteti mbikëqyrës përkatës sipas rregullave sektoriale;

b) vlerësimin e përgjithshëm mbikëqyrës të situatës financiare të një konglomerati financiar;

c) vlerësimin e përputhshmërisë me rregullat mbi mjaftueshmërinë e kapitalit, si dhe të përqendrimit të rreziqeve dhe transaksioneve brenda grupit, sipas përcaktimeve në nenet 6, 7 dhe 8 të këtij ligji;

d) vlerësimin e strukturës, organizimit dhe sistemit të kontrollit të brendshëm të konglomeratit financiar, sipas përcaktimeve në nenin 9 të këtij ligji;

e) planifikimin dhe koordinimin e veprimtarive mbikëqyrëse, si në kushte normale biznesi, ashtu edhe në situata emergjente, në bashkëpunim me autoritetet mbikëqyrëse përkatëse të përfshira;

f) detyrat, masat dhe vendimet e tjera që i ngarkohen koordinatorit nga ky ligj ose nga aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

Për të lehtësuar dhe mundësuar mbikëqyrjen shtesë, koordinatori dhe autoritetet e tjera mbikëqyrëse përkatëse, dhe sipas rastit, autoritetet e tjera kompetente

të përfshira, duhet të kenë marrëveshje koordinimi të miratuara. Marrëveshjet e koordinimit mund t'i ngarkojnë detyra shtesë koordinatorit dhe mund të specifikojnë procedurat për procesin e vendimmarrjes midis autoriteteve mbikëqyrëse, siç përmendet në nenet 3 dhe 4, nenin 5, pika 4, nenin 6, nenin 14, pika 2 dhe nenet 20 dhe 22 të këtij ligji, si dhe për bashkëpunimin me autoritetet e tjera kompetente.

2. Në rastet kur ka nevojë për informacione që tashmë i janë dhënë një tjetër autoriteti mbikëqyrës, koordinatori duhet të kontaktojë me këtë autoritet, kur është e mundur, për të parandaluar duplikimin e raportimit për autoritete të ndryshme të përfshira në mbikëqyrje.

3. Pa cenuar përgjegjësitë dhe kompetencat mbikëqyrëse, të parashikuar në rregullat sektoriale të secilit autoritet mbikëqyrës, prania e koordinatorit të ngarkuar me detyra specifike lidhur me mbikëqyrjen shtesë të subjekteve të mbikëqyrura në një konglomerat financiar nuk ndikon në detyrat dhe përgjegjësitë e autoriteteve mbikëqyrëse të cilat mbeten të paprekura.

4. Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse i parashikuar në këtë Pjesë (Seksion), si dhe ushtrimi i detyrave të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni dhe në nenin 14 të këtij ligji, si dhe, sipas rastit, bashkëpunimi dhe koordinimi me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të treta, në përputhje me kërkesat për konfidencialitet dhe me rregullat përkatëse sektoriale, realizohet edhe përmes kolegeve mbikëqyrës të ngritur për këtë qëllim, në nivel kombëtar apo ndërkombëtar.

Marrëveshjet e koordinimit të përmendura në nënparagrafin e dytë të pikës 1 të këtij neni, pasqyrohen veçmas në marrëveshjet e koordinimit me shkrim ndërmjet autoriteteve përkatëse, të cilat përcaktojnë ndarjen e detyrave dhe procedurat e bashkëpunimit në mbikëqyrjen shtesë.

Koordinatori, në cilësinë e drejtuesit të kolegjit mbikëqyrës, përcakton se cilat autoritete mbikëqyrëse do të marrin pjesë në një mbledhje apo veprimtari të caktuar të këtij kolegji.

5. Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miratojnë udhëzime të përbashkëta lidhur me marrëveshjet e koordinimit ndërmjet tyre, të parashikuara në këtë nen, për të unifikuar procedurat dhe bashkëpunimin në kuadër të mbikëqyrjes shtesë.

Neni 14

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit midis autoriteteve mbikëqyrëse

1. Autoritetet mbikëqyrëse të subjekteve të mbikëqyrura në një konglomerat financiar dhe autoriteti mbikëqyrës i caktuar si koordinator për atë konglomerat financiar, bashkëpunojnë ngushtësisht me njëri-tjetrin. Pa cenuar përgjegjësitë e tyre përkatëse të përcaktuara në rregullat sektoriale përkatëse, këto autoritete i vënë në dispozicion njëri-tjetrit, çdo informacion thelbësor ose të rëndësishëm për ushtrimin e detyrave mbikëqyrëse, në përputhje me rregullat e tyre sektoriale dhe me këtë ligj. Në këtë drejtim, autoritetet mbikëqyrëse dhe koordinatori i komunikojnë njëri-tjetrit, sipas kërkesës, të gjitha informacionet e rëndësishme dhe, me iniciativën e tyre, çdo informacion thelbësor.

Ky bashkëpunim përfshin, të paktën, mbledhjen dhe shkëmbimin e informacionit lidhur me aspektet në vijim:

a) identifikimin e strukturës ligjore të grupit, si dhe të strukturës së qeverisjes dhe asaj organizative, duke përfshirë të gjitha subjektet e mbikëqyrura, subjektet e pa mbikëqyrura dhe degët apo shoqëritë e kontrolluara që i përkasin konglomeratit financiar, zotëruesit e pjesëmarrjeve influencuese në nivelin e shoqërisë mëmë, si dhe autoritetet mbikëqyrëse të subjekteve të mbikëqyrura të grupit;

b) politikat strategjike të konglomeratit financiar;

c) situatën financiare të konglomeratit financiar, në veçanti për mjaftueshmërinë e kapitalit, transaksionet brenda grupit, përqendrimin e rrezikut dhe përfitueshmërinë;

d) aksionarët e shumicës dhe drejtuesit e konglomeratit financiar;

e) organizimin, administrimin e rrezikut dhe sistemet e kontrollit të brendshëm në nivelin e konglomeratit financiar;

f) procedurat për mbledhjen e informacionit nga subjektet në një konglomerat financiar dhe verifikimin e këtij informacioni;

g) zhvillimet negative në subjektet e mbikëqyrura ose në subjektet e tjera të konglomeratit financiar, të cilat mund të kenë ndikim serioz te subjektet e mbikëqyrura;

h) sanksionet dhe masat e jashtëzakonshme të ndërmarra nga autoritetet mbikëqyrëse në përputhje me rregullat sektoriale ose me këtë ligj.

Autoritetet mbikëqyrëse mund të shkëmbejnë gjithashtu informacione për realizimin e detyrave të tyre specifike, lidhur me subjektet e mbikëqyrura në një konglomerat financiar, në përputhje me rregullat e tyre sektoriale.

2. Pa cenuar përgjegjësitë sipas rregullave sektoriale përkatëse, autoritetet mbikëqyrëse, përpara se të marrin vendimin e tyre, konsultohen me njëra-tjetrën lidhur me aspektet në vijim, kur këto vendime janë me rëndësi për detyrat mbikëqyrëse të tyre:

a) ndryshimet e aksionarëve, si dhe të strukturës organizative ose drejtuese të subjekteve të mbikëqyrura në një konglomerat financiar, për të cilat kërkohet miratim ose autorizim nga autoritetet mbikëqyrëse;

b) sanksionet ose masat e ndërmarra nga autoritetet mbikëqyrëse.

Një autoritet mbikëqyrës mund të vendosë të mos konsultohet në raste urgjente ose kur këto konsultime mund të vënë në rrezik efektivitetin e vendimeve. Në këtë rast, autoriteti mbikëqyrës informon, pa vonesa, autoritetin tjetër mbikëqyrës.

3. Koordinator mund të ftojë autoritetet mbikëqyrëse të shtetit ku ka selinë një shoqëri mëmë, të cilat nuk e ushtrojnë vetë mbikëqyrjen shtesë në përputhje me nenin 12 të këtij ligji, që t'i kërkojnë shoqërisë mëmë çdo informacion që do të ishte me rëndësi për ushtrimin e detyrave të saj të koordinimit të përcaktuara në nenin 13 të këtij ligji, si dhe që t'ia përcjellin këtë informacion koordinatorit.

4. Kur informacioni i përmendur në nenin 18, pika 2 të këtij ligji i është dhënë tashmë një autoriteti mbikëqyrës sipas rregullave sektoriale, autoritetet mbikëqyrëse i kërkojnë autoritetit që e zotëron këtë informacion për ta marrë atë.

5. Autoritetet mbikëqyrëse shkëmbejnë informacionet ndërmjet tyre, si dhe midis tyre dhe autoriteteve të tjera të përmendura në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni. Mbledhja ose zotërimi i informacionit mbi një subjekt në një konglomerat financiar, i cili nuk është subjekt i mbikëqyrur, nuk nënkupton në asnjë rast se autoritetet mbikëqyrëse duhet të ushtrojnë funksione mbikëqyrëse lidhur me atë subjekt.

6. Informacioni i marrë në kuadër të mbikëqyrjes shtesë dhe, në veçanti, çdo shkëmbim informacioni ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse, si dhe midis autoriteteve mbikëqyrëse dhe autoriteteve të tjera, siç parashikohet në këtë ligj, është subjekt i dispozitave për sekretin profesional dhe për ruajtjen e konfidencialitetit të parashikuara në rregullat e tyre sektoriale.

Neni 15

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit me Komitetin e Përbashkët

1. Autoritetet mbikëqyrëse dhe koordinatori i caktuar për atë konglomerat financiar shkëmbejnë të gjitha informacionet që janë thelbësore ose të rëndësishme për kryerjen e detyrave brenda kompetencave të tyre, në përputhje me rregullat sektoriale dhe këtë ligj, dhe në këtë kuadër, autoriteti mbikëqyrës kompetent i vë në dispozicion, me nismën e tij ose me nismën e autoritetit tjetër mbikëqyrës kompetent, autoritetit tjetër të gjitha informacionet përkatëse për kryerjen e detyrave brenda kompetencave të tij.

2. Kur autoriteti mbikëqyrës, bazuar në shkëmbimin e informacionit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, nuk merr informacion të mjaftueshëm dhe të nevojshëm për kryerjen e detyrave brenda kompetencave të tij në përputhje me këtë ligj, mund ta kërkojë këtë informacion drejtpërdrejt nga subjekti i mbikëqyrur.

3. Për qëllim të llogaritjes së mjaftueshmërisë së fondeve të veta, autoritetet mbikëqyrëse përkatëse kërkojnë informacionin e nevojshëm nga anëtari që udhëheq grupin. Ky informacion përfshin në veçanti:

- a) të dhënat nga pasqyrat financiare për tre vitet e fundit;
- b) ekstrakte nga regjistri i aksionarëve ose libri i aksioneve në origjinal ose kopje të tij;
- c) raport mbi llogaritjen e kërkesave për kapital; dhe
- ç) struktura e grupit.

4. Autoritetet kompetente shkëmbejnë gjithashtu informacion mbi subjektet e rregulluara në një konglomerat financiar me bankat qendrore të Shteteve Anëtare, Sistemin Evropian të Bankave Qendrore, Bankën Qendrore Evropiane dhe Bordin Evropian të Rrezikut Sistemik, në përputhje me Nenin 15 të Rregullores (BE) Nr. 1092/2010.

5. Autoritetet mbikëqyrëse bashkëpunojnë me Komitetin e Përbashkët për qëllime të

mbikëqyrjes shtesë të konglomerateve financiare, në përputhje me praktikat dhe standardet ndërkombëtare për bashkëpunim ndërinstitucional në mbikëqyrjen financiare ndërsektoriale.

6. Autoritetet mbikëqyrëse vënë në dispozicion të Komitetit të Përbashkët, pa vonesa, çdo informacion që konsiderohet i nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tij në lidhje me bashkërendimin dhe harmonizimin e mbikëqyrjes shtesë.

7. Koordinator i konglomeratit financiar i siguron Komitetit të Përbashkët informacionin që lidhet me strukturën ligjore, strukturën e qeverisjes dhe organizimin e brendshëm të konglomeratit financiar, si dhe informacionin e parashikuar në nenin 9, pika 4 dhe në nenin 14, pika 1, shkronja “a”.

8. Gjatë ushtrimit të detyrave dhe kompetencave të parashikuara në këtë ligj, autoritetet mbikëqyrëse duhet t’u përmbahen udhëzimeve, standardeve dhe rekomandimeve të tjera të lëshuara nga Komiteti i Përbashkët dhe Komisioni Evropian.

Neni 16

Detyrimi dhe organet drejtuese të shoqërisë financiare zotëruese të përzier

1. Shoqëria e financiare zotëruese e përzierë duhet, pa vonesë të panevojshme, t’i njoftojë koordinatorit për personat e emëruar në organet drejtuese të asaj shoqërie.

2. Personat të cilët drejtojnë efektivisht veprimtarinë e një shoqërie financiare zotëruese të përzier duhet të kenë një reputacion të mirë dhe përvojë të mjaftueshme për përmbushjen e detyrave të tyre drejtuese, të cilat janë të barasvlershme me kriteret e përcaktuara në legjislacionin apo aktet rregullatore sektoriale për administratorët, anëtarët e këshillave mbikëqyrës dhe aksionarëve të institucioneve të kreditit, shoqërive të sigurimit dhe subjekteve të tjera financiare të mbikëqyrura.

3. Nëse e vlerësojnë të arsyeshme, autoritetet mbikëqyrëse përcaktojnë në rregulloret e tyre kriteret shtesë në nivelin e konglomeratit financiar për vlerësimin e reputacionit dhe përvojës, duke marrë në konsideratë standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian.

Neni 17

Aksesi në informacion

1. Personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në objektin e mbikëqyrjes shtesë, pavarësisht nëse janë subjekte të rregulluara ose jo, duhet të dorëzojnë çdo informacion që është me rëndësi për qëllime të mbikëqyrjes shtesë, si dhe të shkëmbejnë informacion me autoritetet mbikëqyrëse në përputhje me këtë ligj.

2. Personat në një konglomerat financiar duhet t’i mundësojë autoritetit kompetent kontrollin e librave të biznesit, dokumenteve të biznesit dhe regjistrave administrativë ose tregtarë, si dhe kontrollin e teknologjisë së informacionit dhe teknologjive të tjera të lidhura, në masën e nevojshme për ushtrimin e mbikëqyrjes shtesë të përmendur në pikën 1 të këtij neni.

3. Subjekti pjesë i një konglomerati financiar duhet t’u dorëzojë personave të autorizuar të autoritetit kompetent regjistrat elektronikë, kopjet e librave të biznesit, dokumentacionin e biznesit dhe regjistrat administrativë ose tregtarë sipas kërkesës së tyre, në formatin e kërkuar (kopje fizike ose kopje elektronike). 4. Autoritetet mbikëqyrëse, gjatë ndërveprimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me subjektet në një konglomerat financiar, pavarësisht nëse janë

subjekte të mbikëqyrura ose jo, kanë akses në çdo informacion që është me rëndësi për qëllime të mbikëqyrjes shtesë.

Neni 18

Verifikimi

1. Autoritetet mbikëqyrëse, për qëllime të zbatimit të këtij ligji, nëse në raste specifike vlerësojnë se duhet të verifikojnë informacionin lidhur me një subjekt, të rregulluar ose jo, që është pjesë e një konglomerati financiar dhe që ndodhet në një shtet tjetër anëtar, kryejnë respektivisht verifikimin në përputhje me kompetencat e tyre ose u kërkojnë autoriteteve mbikëqyrëse të këtij shteti anëtar që të mundësojë kryerjen e verifikimit.
2. Autoritetet mbikëqyrëse shqiptare mund të lidhin marrëveshje me një ose disa autoritete kompetente të vendeve të treta, e cila siguron bazën për shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për ushtrimin e mbikëqyrjes shtesë mbi subjektet e mbikëqyrura në një konglomerat financiar.
3. Autoritetet mbikëqyrëse shqiptare mund t'i propozojnë Komisionit Evropian lidhjen e një marrëveshjeje me një ose disa vende të treta për qëllime të ushtrimit të mbikëqyrjes shtesë mbi subjektet e mbikëqyrura në një konglomerat financiar.
4. Bashkëpunimi midis Autoriteteve mbikëqyrëse vendase ose të shteteve të tjera anëtare do të bazohet në parashikimet e nenit 10 të këtij ligji.

Neni 19

Masat zbatuese

1. Nëse subjektet e mbikëqyrura që bëjnë pjesë në një konglomerat financiar nuk respektojnë kërkesat e përcaktuara në nenet 6 deri në 9 të këtij ligji, ose nëse këto kërkesa përmbushen, por gjithsesi vihet në rrezik gjendja financiare dhe niveli i kapitalizimit të tyre, apo kur transaksionet brenda grupit ose përqendrimet e rrezikut paraqesin kërcënim për pozicionin financiar të subjekteve të mbikëqyrura, merren masat e nevojshme për të korrigjuar situatën sa më shpejt që të jetë e mundur:

- a) nga koordinatori, në lidhje me shoqërinë financiare zotëruese të përzier;
- b) nga autoritetet mbikëqyrëse, në lidhje me subjektet e mbikëqyrura dhe për këtë qëllim, koordinatori informon autoritetet mbikëqyrëse përkatëse lidhur me gjetjet e tij.

2. Pa cenuar nenin 21, pika 2 të këtij ligji, autoritetet mbikëqyrëse miratojnë, në përputhje me rregullat e tyre sektoriale, akte rregullatore të posaçme si vijon:

- a) Banka e Shqipërisë miraton aktet nënligjore për metodologjinë e llogaritjes së mjaftueshmërisë së kapitalit në nivelin e konglomeratit financiar, mbikëqyrjen shtesë të transaksioneve ndërmjet subjekteve të grupit dhe përqendrimit të rrezikut brenda konglomeratit financiar, si dhe udhëzimet për harmonizimin e praktikave mbikëqyrëse që lidhen me marrëveshjet e bashkëpunimit për konglomeratet financiare, për institucionin e kreditit që është në krye të grupit, sipas nenit 12 të këtij ligji.

- b) Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miraton aktet nënligjore për metodologjinë e llogaritjes së mjaftueshmërisë së kapitalit në nivelin e konglomeratit financiar, mbikëqyrjen shtesë të transaksioneve ndërmjet subjekteve të grupit dhe përqendrimit të rrezikut brenda konglomeratit financiar, si dhe udhëzimet për harmonizimin e praktikave mbikëqyrëse që lidhen me marrëveshjet e bashkëpunimit për konglomeratet financiare, për shoqërinë administruese të

sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërinë administruese të fondeve të investimeve alternative

c) Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miraton aktet nënligjore për metodologjinë e llogaritjes së mjaftueshmërisë së kapitalit në nivelin e konglomeratit financiar, mbikëqyrjen shtesë të transaksioneve ndërmjet subjekteve të grupit dhe përqendrimit të rrezikut brenda konglomeratit financiar, si dhe udhëzimet për harmonizimin e praktikave mbikëqyrëse që lidhen me marrëveshjet e bashkëpunimit për konglomeratet financiare, për shoqëritë komisionere, shoqëritë e sigurimit ose shoqëritë e risigurimit që janë anëtarë në krye të grupit, sipas nenit 18, pika 1 të këtij ligji.³ Autoritetet mbikëqyrëse, përfshirë koordinatorin, miratojnë në akte rregullatore të përbashkëta masat e zbatueshme sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni si dhe masat e zbatueshme ndaj shoqërive financiare zotëruese të përziera, në përputhje me standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare të mbikëqyrjes financiare ndërsektoriale.

Neni 20

Kompetencat shtesë të autoriteteve mbikëqyrëse

1. Autoritetet mbikëqyrëse kanë kompetencën të ndërmarrin çdo masë mbikëqyrëse që vlerësohet e nevojshme për të parandaluar ose trajtuar përpjekjet për anashkalimin e rregullave sektoriale nga subjektet e mbikëqyrura që bëjnë pjesë në një konglomerat financiar.

2. Pa cenuar dispozitat përkatëse të legjislacionit penal, autoritetet mbikëqyrëse sigurojnë që ndaj shoqërive financiare zotëruese të përziera, apo ndaj personave që ushtrojnë efektivisht funksionet drejtuese në to, të cilët shkelin dispozitat ligjore, rregulloret apo aktet nënligjore të miratuara për zbatimin e këtij ligji, të mund të vendosen masa apo sanksione me qëllim ndalimin e shkeljeve të konstatuara ose eliminimin e shkaqeve të tyre.

3. Autoritetet mbikëqyrëse bashkëpunojnë ngushtësisht për të garantuar që këto masa ose sanksione të japin efektin e dëshiruar.

PJESA IV VENDET E TRETA

Neni 21

Shoqëritë mëmë me seli në një vend të tretë

1. Pa cenuar rregullat sektoriale, në rastet kur zbatohen dispozitat e nenit 5, pika 3 të këtij ligji, autoritetet mbikëqyrëse verifikojnë nëse subjektet e mbikëqyrura, shoqëria mëmë e të cilave ka selinë në një vend të tretë, janë objekt i një mbikëqyrjeje të ushtruar nga autoriteti mbikëqyrës i atij vendi, e cila është e barasvlefshme me mbikëqyrjen shtesë të parashikuar në këtë ligj për subjektet e mbikëqyrura të përmendura në nenin 5, pika 2 të këtij ligji. Ky verifikim kryhet nga autoriteti mbikëqyrës që do të ishte caktuar si koordinator nëse do të zbatoheshin kriteret e përcaktuara në nenin 12, pika 2 të këtij ligji, me kërkesë të shoqërisë mëmë, të njërit prej subjekteve të mbikëqyrura brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ose në Bashkimin Evropian, ose me nismën e vet autoritetit mbikëqyrës.

2. Për kryerjen e verifikimit të parashikuar në këtë nen, autoriteti mbikëqyrës në fjalë konsultohet me autoritetet e tjera mbikëqyrëse përkatëse dhe merr në konsideratë praktikatat më të mira të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe çdo udhëzim të përbashkët të nxjerrë nga mekanizmat institucionalë të bashkërendimit mbikëqyrës në nivel ndërkombëtar.

3. Në mungesë të mbikëqyrjes së barasvlefshme të përmendur në pikën 1 të këtij neni, zbatohen me analogji dispozitat e këtij ligji që lidhen me mbikëqyrjen shtesë të subjekteve të përfshira në konglomerate financiare, siç parashikohet në nenin 5, pika 2 të këtij ligji. Si alternativë, autoritetet mbikëqyrëse mund të zbatojnë një nga metodat e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni.

4. Autoritetet mbikëqyrëse mund të zbatojnë metoda të tjera që garantojnë ushtrimin efektiv të mbikëqyrjes shtesë ndaj subjekteve të mbikëqyrura që janë pjesë e një konglomerati financiar. Këto metoda miratohen nga koordinatori, pas konsultimit me autoritetet e tjera mbikëqyrëse përkatëse. Në veçanti, autoritetet mbikëqyrëse mund të kërkojnë krijimin e një shoqërie financiare zotëruese të përzier, me seli në Republikën e Shqipërisë, dhe të zbatojnë dispozitat e këtij ligji ndaj konglomeratit financiar të kryesuar nga kjo shoqëri. Autoritetet mbikëqyrëse marrin masa që të sigurojnë se këto metoda arrijnë objektivat e mbikëqyrjes shtesë në përputhje me këtë ligj dhe njoftojnë autoritetet mbikëqyrëse të tjera përkatëse për masat e ndërmarra.

5. Subjekti i mbikëqyrur me seli në Republikën e Shqipërisë, shoqëria mëmë e të cilit është person juridik me seli të regjistruar në një vend të tretë dhe i cili është i përfshirë në një konglomerat financiar ose shoqëri zotëruese financiare e përzier me seli në një vend të tretë dhe që ka shoqëri bijë në Republikën e Shqipërisë, i nënshtrohet mbikëqyrjes shtesë në nivelin e konglomeratit financiar në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 22

Bashkëpunimi me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të treta

1. Autoritetet Mbikëqyrëse shqiptare, mund të nënshkruajnë marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe bashkëpunimi me një ose disa autoritete mbikëqyrëse të vendeve të treta lidhur me mënyrat e ushtrimit të mbikëqyrjes shtesë të subjekteve të mbikëqyrura që janë pjesë e një konglomerati financiar.
2. Autoritetet mbikëqyrëse shqiptare ndjekin procedurat përkatëse të parashikuara në legjislacionin që rregullon fushën e organizimit dhe funksionimit të tyre për lidhjen e marrëveshjeve me autoritetet e huaja, dhe për këtë qëllim mund të marrin si referencë praktikat e bashkëpunimit të zbatuara në mbikëqyrjen e bankave, të shoqërive të sigurimit dhe të shoqërive komisionere në nivel ndërkombëtar.

KREU III

SHOQËRITË ADMINISTRUESE DHE SHOQËRITË ADMINISTRUESE TË FONDEVE TË INVESTIMEVE ALTERNATIVE

Neni 23

Shoqëritë administrative

1. Për qëllime të zbatimit të këtij ligji shoqëritë administrative përfshihen:
 - a) në objektin e mbikëqyrjes së konsoliduar të institucioneve të kreditit, ose në mbikëqyrjen shtesë të shoqërive të sigurimit që janë pjesë e një grupi sigurimi;
 - b) në mbikëqyrjen shtesë të parashikuar në këtë ligj, nëse grupi përbën një konglomerat financiar; dhe
 - c) në procesin e identifikimit të konglomeratit financiar, sipas përcaktimeve të nenit 3,

pika 2 të këtij ligji.

2. Për zbatimin e pikës 1 të këtij neni, autoritetet mbikëqyrëse përkatëse, në varësi të strukturës së grupit, vendosin rast pas rasti sipas cilave rregulla sektoriale do të mbikëqyret një shoqëri administruese në kuadër të mbikëqyrjes së konsoliduar dhe/ose mbikëqyrjes shtesë të përmendur në pikën 1, shkronja “a” të këtij neni. Për qëllime të kësaj dispozite, rregullat sektoriale përkatëse lidhur me formën dhe shkallën e përfshirjes së institucioneve financiare (kur shoqëritë administruese përfshihen në mbikëqyrjen e konsoliduar të institucioneve të kreditit dhe shoqërive komisionere), ose të shoqërive të risigurimit (kur përfshihen në mbikëqyrjen plotësuese të grupeve të sigurimit), zbatohen *mutatis mutandis* për shoqëritë administruese.

3. Për qëllime të mbikëqyrjes shtesë të përmendur në pikën 1, shkronja “b” të këtij neni, shoqëria administruese konsiderohet pjesë e atij tregu në të cilin është përfshirë sipas vendimit të marrë në përputhje me pikën 1, shkronja “a” të këtij neni.

4. Kur një shoqëri administruese është pjesë e një konglomerati financiar, çdo referencë në këtë ligj ndaj termit “subjekt i mbikëqyrur”, “autoritet mbikëqyrës” ose “autoritet mbikëqyrës përkatës”, interpretohet, për qëllime të këtij ligji, si përfshirje përkatësisht edhe e shoqërive administruese dhe e autoritetit mbikëqyrës përgjegjës për to. Kjo dispozitë zbatohet *mutatis mutandis* edhe për grupet e përmendura në pikën 1, shkronja “a” të këtij neni.

Neni 24

Administruesit e fondeve të investimeve alternative

1. Dispozitat e nenit 24 të këtij ligji zbatohen *mutatis mutandis* edhe për shoqëritë administruese të fondeve të investimeve alternative (AFIA).

2. Autoritetet mbikëqyrëse përkatëse përcaktojnë rregullat sektoriale për mbikëqyrjen e AFIA-ve, në përputhje me rregullat sektoriale në fuqi. Forma dhe niveli i përfshirjes në mbikëqyrjen e konsoliduar ose shtesë përcaktohet në përputhje me rastin.

3. Kur një AFIA është pjesë e një konglomerati financiar, çdo referencë në këtë ligj ndaj “subjektit të mbikëqyrur”, “autoritetit mbikëqyrës” dhe “autoritetit mbikëqyrës përkatës” interpretohet si përfshirje edhe e shoqërisë administruese të fondeve të investimeve alternative dhe e autoritetit që mbikëqyr atë.

KREU IV

SANKSIONET DHE DISPOZITA TË PËRGJITHSHME ZBATIMI

Neni 25

Masat administrative

1. Shoqëria financiare zotëruese e përzier, subjekti i mbikëqyrur ose çdo person tjetër juridik pjesë e konglomeratit financiar gjobitet në vlerën nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 5 000 000 (pesë milionë) lekë, në rastet kur:
 - a) Nuk njofton koordinatorin mbi ndërprerjen e plotësimit të kushteve për ekzistencën e konglomeratit financiar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e ndërprerjes së plotësimit të këtyre kushteve, sipas nenit 4, pika 5 të këtij ligji
 - b) Nuk mban nivelin e përshtatshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit në nivelin e

konglomeratit financiar, sipas kërkesave të përcaktuara në nenin 6, pika 1 të këtij ligji;

- c) Nuk monitoron përqendrimet e rrezikut në nivelin e konglomeratit financiar, sipas nenit 7 të këtij ligji;
- d) Nuk monitoron transaksionet e rëndësishme ndërmjet subjekteve të mbikëqyrura në konglomeratin financiar, sipas nenit 8 të këtij ligji;
- e) Përveç kërkesave të nenit 6 të këtij ligji, nuk miraton dhe nuk zbaton politikat për mjaftueshmërinë e fondeve të veta;
- f) Përveç kërkesave të nenit 6 të këtij ligji, nuk krijon dhe nuk zbaton një sistem të efektshëm dhe të besueshëm të menaxhimit të rrezikut;
- g) Përveç kërkesave të nenit 6 të këtij ligji, nuk krijon dhe nuk zbaton një sistem të efektshëm të kontrollit të brendshëm në të gjitha fushat e veprimtarisë, veçanërisht në procedurat administrative dhe kontabël, sipas nenit 9, pika 1 të këtij ligji;
- h) Nuk ushtron mbikëqyrjen e subjekteve të mbikëqyrura për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në nenet 6 dhe 9 të këtij ligji;
- i) Nuk kryen rregullisht dhe të paktën njëherë në vit përlllogaritjen e fondeve të veta dhe kërkesave shtesë kapitale dhe nuk ia dorëzon koordinatorit rezultatet e përlllogaritjes, sipas nenit 6, pika 2 të këtij ligji;
- j) Nuk i raporton rregullisht dhe të paktën njëherë në vit koordinatorit çdo përqendrim të konsiderueshëm rreziku në nivelin e konglomeratit financiar, sipas nenit 7, pika 2 të këtij ligji;
- k) Nuk i raporton rregullisht dhe të paktën njëherë në vit koordinatorit transaksionet e rëndësishme ndërmjet subjekteve të mbikëqyrura në konglomeratin financiar, sipas nenit 8, pika 2 të këtij ligji;
- l) Nuk i jep, në nivelin e konglomeratit financiar, çdo vit autoriteteve mbikëqyrëse kompetente informacion mbi strukturën, drejtimin dhe organizimin e konglomeratit financiar, përfshirë të dhëna mbi të gjitha subjektet e mbikëqyrura, shoqëritë e varura jo të mbikëqyrura dhe degët e rëndësishme, sipas nenit 9, pika 4 të këtij ligji;
- m) Nuk publikon çdo vit, në nivelin e konglomeratit financiar, përshkrimin e strukturës, drejtimit dhe organizimit të konglomeratit financiar, sipas nenit 9, pika 4 të këtij ligji;
- n) Nuk njofton, koordinatorin mbi personat e emëruar në organet drejtuese të saj, sipas nenit 17 të këtij ligji;
- o) Nuk i mundëson autoritetit mbikëqyrës ushtrimin e mbikëqyrjes shtesë të veprimtarisë së tij në zyrën qendrore dhe në vendet e tjera ku kryen aktivitet, sipas nenit 18, pika 1 të këtij ligji;
- p) Nuk i mundëson autoritetit mbikëqyrës kontrollin e librave të biznesit, dokumentacionit, regjistrave dhe sistemeve të informacionit, sipas nenit 18, pika 2 të këtij ligji;
- q) Nuk i dorëzon autoritetit mbikëqyrës regjistrat elektronikë, kopjet e librave të biznesit dhe dokumentacionit administrativ në formatin e kërkuar, sipas nenit 18, pika 3 të këtij ligji;
- r) Nuk zbaton dispozitat e këtij ligji brenda afatit të përcaktuar në nenin 28 të këtij ligji.
- s) Nuk bashkëpunon me koordinatorin ose me autoritetet e tjera mbikëqyrëse në

- zbatimin e detyrimeve të përcaktuara nga ky ligj ose nuk siguron akses në informacionin e kërkuar nga këto autoritete;
- t) Nuk i raporton koordinatorit ose autoriteteve mbikëqyrëse në rastet e parashikuara në nenet 4 dhe 5 të këtij ligji, për ndryshime të rëndësishme në strukturën e pronësisë ose në përbërjen e grupit.
2. Përveç gjobës, autoritetet mbikëqyrëse mund të vendosin ndaj subjektit shkelës masa plotësuese administrative, si:
- a) paralajmërim publik;
- b) urdhër për përmirësimin e mangësive brenda një afati të caktuar;
- c) ndalim përkohshëm të kryerjes së veprimtarive të caktuara; ose
- ç) pezullimin e anëtarëve të organeve drejtuese deri në korrigjimin e shkeljeve.
3. Në rastet e përsëritjes së shkeljeve brenda një periudhe dyvjeçare, masa e gjobës dyfishohet.
4. Personi përgjegjës që kryen shkeljet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, si dhe çdo person fizik që pengon ushtrimin e mbikëqyrjes, gjobitet nga 100 000 (njëqind mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.
5. Masa administrative sipas këtij neni vendosen nga autoriteti mbikëqyrës përkatës ose koordinatori, sipas kompetencës së përcaktuar në këtë ligj.
6. Zbatimi i këtij neni nuk cenon kompetencat e autoriteteve mbikëqyrëse për të ndërmarrë masa apo sanksione të tjera administrative, sipas legjislacionit sektorial që rregullon veprimtarinë e subjekteve të mbikëqyrura.

Neni 26

Aktet nënligjore

1. Brenda dymbëdhjetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, secili për fushën e vet të përgjegjësisë, miratojnë ose përshtatin rregullat e tyre sektoriale me qëllim zbatimin e këtij ligji, përfshirë metodologjinë e përlllogaritjes së kërkesave për mjaftueshmërinë e kapitalit (sipas metodave të përcaktuara në Shtojcën 1), fondet e veta, aftësinë paguese, kufizimet për transaksionet brenda grupit dhe përqendrimin e rrezikut në nivelin e konglomeratit financiar.

2. Brenda dymbëdhjetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miratojnë udhëzime të përbashkëta për të siguruar zbatim të harmonizuar ndërsektorial të këtij ligji sipas nenit 20 të tij dhe për të shmangur mbivendosjen e kërkesave prudenciale për subjektet e mbikëqyrura që janë pjesë e një konglomerati financiar.

3. Në zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore përkatëse, Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare marrin në konsideratë udhëzimet, opinionet, dhe standardet teknike të hartuara nga Autoriteti Bankar Evropian (EBA), Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA), dhe Autoriteti Evropian i Titujve dhe Tregjeve (ESMA), për aq sa janë të përshtatshme dhe të aplikueshme në kontekstin e legjislacionit shqiptar.

4. Brenda dymbëdhjetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, me qëllim sigurimin e praktikave të njëtrajtshme mbikëqyrëse dhe plotësimin e kërkesave të këtij ligji në mënyrë të harmonizuar ndërmjet sektorëve, Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miratojnë udhëzimet e përbashkëta lidhur me:

- (i) pragjet dhe përcaktimi i sektorëve të rëndësishëm financiarë sipas nenit 3, pika 14;
- (ii) përqendrimi i rrezikut në nivel konglomerati financiar sipas nenit 7, pika 5;
- (iii) transaksionet brenda grupit sipas nenit 8, pika 5;
- (iv) proceset e administrimit të rrezikut dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm sipas nenit 9, pika 8;
- (v) mbi mënyrën e kryerjes së vlerësimeve të bazuara në rrezik ndaj konglomerateve financiare, si dhe për zhvillimin e praktikave të harmonizuara të mbikëqyrjes ndërsektoriale në zbatim të nenit 10, pika 3; dhe
- (vi) marrëveshjet e koordinimit ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse sipas nenit 13, pika 5;

Neni 27 **Dispozita kalimtare**

Subjektet e mbikëqyrura duhet të përmbushin dispozitat e këtij ligji brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji .

Neni 28 **Dispozitë kalimtare për hyrjen në fuqi të disa neneve të këtij ligji**

1. Dispozitat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, të cilat përbëjnë transpozimin e Direktivës (BE) 2002/87/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 Dhjetor 2002, mbi mbikëqyrjen plotësuese të institucioneve të kreditit, shoqërive të sigurimeve dhe shoqërive komisionere në një konglomerat financiar, si dhe për ndryshimin e Direktivave 73/239/CEE, 79/267/CEE, 92/49/CEE, 92/96/CEE, 93/6/CEE dhe 93/22/CEE të Këshillit dhe Direktivave 98/78/EC dhe 2000/12/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e ndryshuar, do të hyjnë në fuqi në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

2. Dispozitat e mëposhtme të këtij ligji do të hyjnë në fuqi në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian:

- a) Neni 4, pika 2, vetëm sa lidhet me njoftimin e autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar dhe të Komitetit të Përbashkët;
- b) Neni 11, pika 3;
- c) Neni 12, pika 4;
- d) Neni 15, pikat 4–8.

Neni 29 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
NIKO PELESHI

ANEKSI I: MJAFTUESHMËRIA E KAPITALIT

Llogaritja e kërkesave shtesë të mjaftueshmërisë së kapitalit të subjekteve të mbikëqyrura në një konglomerat financiar, të përmendura në nenin 6, pika 1 të këtij ligji, kryhet në përputhje me parimet teknike dhe njërën prej metodave të përshkruara në këtë Aneks.

Pa cenuar dispozitat e paragrafit pasardhës, autoriteti mbikëqyrës përkatës, kur ushtron rolin e koordinatorit ndaj një konglomerati financiar të caktuar, vendos, pas konsultimit me autoritetet e tjera mbikëqyrëse dhe me vetë konglomeratin, se cila metodë do të zbatohet nga ky konglomerat financiar. Kur një konglomerat financiar kryesohet nga një subjekt i mbikëqyrur i cili është i licencuar në Republikën e Shqipërisë, autoriteti mbikëqyrës që e ka licencuar mund të kërkojë që llogaritja të kryhet sipas një metode të caktuar ndër ato të përshkruara në këtë Aneks. Kur një konglomerat financiar nuk kryesohet nga një subjekt i mbikëqyrur në kuptim të këtij ligji, lejohet zbatimi i cilësdo prej metodave të përshkruara në këtë Aneks.

I. Parimet teknike

1. Shtrirja dhe forma e llogaritjes së kërkesave shtesë të mjaftueshmërisë së kapitalit

Cilado qoftë metoda e përdorur, kur subjekti është një shoqëri bijë dhe ka mangësi (pamjaftueshmëri) të kapitalit, ose, në rastin e një subjekti që është pjesë e grupit, por që nuk është i licencuar apo i mbikëqyrur nga një autoritet mbikëqyrës, por që ushtron veprimtari në sektorin financiar, ka një pamjaftueshmëri të kapitalit të llogaritur në mënyrë hipotetike (kërkesë e supozuar e kapitalit e paplotësuar), kjo mangësi merret parasysh në tërësi në përllogaritje.

Nëse, sipas vlerësimit të koordinatorit, përgjegjësia e shoqërisë mëmë që zotëron pjesërisht kapitalin e shoqërisë bijë është e kufizuar vetëm në këtë pjesë kapitali, atëherë koordinatori mund të lejojë që pamjaftueshmëria e kapitalit të merret në konsideratë vetëm në përpjesëtim me pjesëmarrjen në kapital.

Në rastet kur ndërmjet subjekteve të përfshira në konglomeratin financiar nuk ekzistojnë lidhje të ngushta, koordinatori, pas konsultimit me autoritetet e tjera mbikëqyrëse përkatëse, përcakton pjesën proporcionale të pamjaftueshmërisë që do të merret në konsideratë, duke u mbështetur në natyrën e përgjegjësisë që rrjedh nga marrëdhëniet e krijuara ndërmjet tyre.

2. Parime të tjera teknike

Pavarësisht se cila metodë përdoret për llogaritjen e kërkesave shtesë të mjaftueshmërisë së kapitalit të subjekteve të mbikëqyrura në një konglomerat financiar, siç parashikohet në Seksionin II të këtij Aneksi, koordinatori dhe, kur është e nevojshme, autoritetet e tjera mbikëqyrëse të përfshira, sigurohen që të zbatohen parimet e mëposhtme:

(i) **Eliminimi i përdorimit të shumëfishtë të elementeve të fondeve të veta ('multiple gearing') dhe çdo krijimi artificial i kapitalit brenda grupit.** Përdorimi i shumëfishtë i elementeve të pranueshme për llogaritjen e fondeve të veta në nivelin e konglomeratit financiar (*multiple gearing*), si edhe çdo krijim i papërshtatshëm i fondeve të veta brenda grupit, duhet të eliminohen. Për të siguruar eliminimin e shumëfishimit të kapitalit dhe krijimit të fondeve brenda grupit, autoritetet mbikëqyrëse, zbatojnë për analogji, parimet përkatëse të parashikuara në rregullat sektoriale përkatëse.

(ii) **Mbulimi i kërkesave për kapital për secilin sektor dhe kufizimet ndërsektoriale.** Kërkesat për kapital për secilin sektor financiar të përfaqësuar në një konglomerat financiar mbulohen nga elementët e fondeve të veta, në përputhje me rregullat sektoriale përkatëse. Kur

rezulton mungesë e fondeve të veta në nivelin e konglomeratit financiar, vetëm elementët e fondeve të veta që janë të pranueshëm sipas secilës prej rregullave sektoriale (kapital ndërsektorial) do të merren në konsideratë për plotësimin e asaj pamjaftueshmërie kapitali. Kur rregullat sektoriale parashikojnë kufizime mbi pranueshmërinë e instrumenteve të caktuara të fondeve të veta, të cilët do të kualifikoheshin si kapital ndërsektorial, këto kufizime zbatohen *mutatis mutandis* gjatë llogaritjes së fondeve të veta në nivelin e konglomeratit financiar. Gjatë llogaritjes së fondeve të veta në nivelin e konglomeratit financiar, autoritetet mbikëqyrëse marrin parasysh edhe efektivitetin e transferueshmërisë dhe disponueshmërisë së fondeve të veta midis subjekteve të ndryshme në grup, duke patur parasysh objektivat e rregullave të mjaftueshmërisë së kapitalit. Kur, në rastin e një subjekti të sektorit financiar jo të mbikëqyruar, llogaritet një kërkesë e supozuar e kapitalit sipas Seksionit II të kësaj Shtojce, “kërkesë e supozuar e kapitalit” nënkupton nivelin e kapitalit me të cilin subjekti do duhej të ishte në përputhje sipas rregullave sektoriale përkatëse, sikur ai të ishte një subjekt i mbikëqyruar i atij tregu financiar. Në rastin e shoqërive administruese, kërkesa e kapitalit nënkupton kërkesën për kapitalin minimal të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e sipërmarrjeve të investimeve kolektive. Kërkesa e kapitalit për një shoqëri financiare zotëruese të përzier llogaritet sipas rregullave sektoriale të atij tregu financiar që përbën sektorin më të rëndësishëm në konglomeratin financiar.

II. Metodatat teknike të llogaritjes

Metoda 1: "Konsolidimi kontabël" – Llogaritja e kërkesave shtesë të mjaftueshmërisë së kapitalit të subjekteve të rregulluara në një konglomerat financiar kryhet mbi bazën e llogarive të konsoliduara. Kërkesat shtesë të mjaftueshmërisë së kapitalit llogariten si diferenca midis:

- a) fondeve të veta të konglomeratit financiar, të llogaritura mbi bazën e pozicionit të konsoliduar të grupit (elementet e pranueshme janë ato që kualifikohen në përputhje me rregullat sektoriale përkatëse); dhe
- b) shumës së kërkesave për kapital për secilin sektor financiar të përfaqësuar në grup (kërkesat për secilin treg llogariten në përputhje me rregullat sektoriale përkatëse) duke përjashtuar çdo krijim të fondeve të veta ndërmjet subjekteve të grupit.

Rregullat sektoriale të referuara përfshijnë, në veçanti, legjislacionin prudencial për institucionet e kreditit, për shoqëritë e sigurimit, si dhe për shoqëritë komisionere. Në rastin e një subjekti që është pjesë e grupit, por që nuk është i licencuar apo i mbikëqyruar nga një autoritet mbikëqyrës, por që ushtron veprimtari në sektorin financiar, që nuk përfshihen në llogaritjen e kërkesave sektoriale të kapitalit si më sipër, llogaritet një kërkesë e supozuar e kapitalit. Diferenca nuk duhet të rezultojë negative.

Metoda 2: "Zbritja dhe agregimi" – Llogaritja e kërkesave shtesë të mjaftueshmërisë së kapitalit të subjekteve të mbikëqyruara në një konglomerat financiar kryhet mbi bazën e llogarive të secilit prej subjekteve në grup. Kërkesat shtesë të mjaftueshmërisë së kapitalit llogariten si diferenca midis:

- a) shumës së fondeve të veta të secilit subjekt (të rregulluar ose jo të rregulluar) në konglomeratin financiar (elementet e pranueshme janë ato që kualifikohen në përputhje me rregullat sektoriale përkatëse); dhe
- b) shumës së:
 - i. kërkesave të kapitalit për secilin subjekt, të rregulluar dhe jo të rregulluar, në grup

- (kërkesat llogariten në përputhje me rregullat sektoriale përkatëse); dhe
- ii. vlerës kontabël të pjesëmarrjeve në shoqëritë e tjera të grupit.

Në rastin e një subjekti që është pjesë e grupit, por që nuk është i licencuar apo i mbikëqyrur nga një autoritet mbikëqyrës, por që ushtron veprimtari në sektorin financiar, llogaritet një kërkesë e supozuar e kapitalit ose aftësisë paguese. Fondet e veta dhe kërkesat e kapitalit merren parasysh në masën e tyre proporcionale, siç parashikohet në nenin 6, pika 4 të këtij ligji dhe në përputhje me Seksionin I të kësaj Shtojce. Diferenca nuk duhet të rezultojë negative.

Metoda 3: Kombinimi i metodave 1 dhe 2– Autoritetet mbikëqyrëse mund të lejojnë një kombinim të metodave 1, 2 dhe 3, ose një kombinim të dy prej këtyre metodave.

ANEKSI II: ZBATIMI TEKNIK I DISPOZITAVE PËR TRANSAKSIONET BRENDA GRUPIT DHE PËRQENDRIMIN E RREZIKUT

Koordinatori, pas konsultimit me autoritetet e tjera mbikëqyrëse, përcakton llojet e transaksioneve dhe të rreziqeve që subjektet e mbikëqyrura në një konglomerat financiar të caktuar duhet të raportojnë, në përputhje me dispozitat e nenit 7, pika 2 dhe nenit 8, pika 2 të këtij ligji, lidhur me raportimin e transaksioneve brenda grupit dhe përqendrimin e rrezikut. Kur përcaktojnë ose shprehin opinionin e tyre mbi llojin e transaksioneve dhe të rreziqeve, koordinatori dhe autoritetet mbikëqyrëse përkatëse marrin në konsideratë strukturën specifike të grupit dhe strukturën e administrimit të rrezikut të atij konglomerati financiar. Për të identifikuar transaksionet e rëndësishme brenda grupit dhe përqendrimet e rëndësishme të rrezikut që do të raportohen sipas neneve 7 dhe 8 të këtij ligji, koordinatori, pas konsultimit me autoritetet mbikëqyrëse dhe me vetë konglomeratin, përcakton pragjet përkatëse bazuar në fondet e veta rregullatore dhe/ose rezervat teknike.

Kur kryen vëzhgimin dhe kontrollin e transaksioneve brenda grupit dhe të përqendrimeve të rrezikut, koordinatori monitoron në veçanti:

- rrezikun e përhapjes së problemeve financiare brenda konglomeratit financiar (efekt *contagion*);
- rrezikun e konfliktit të interesave;
- rrezikun e anashkalimit të rregullave sektoriale;
- nivelin ose volumin e rreziqeve.

Autoritetet mbikëqyrëse zbatojnë, në nivelin e konglomeratit financiar, dispozitat e rregullave sektoriale mbi transaksionet brenda grupit dhe përqendrimin e rrezikut, veçanërisht për të shmangur anashkalimin e rregullave sektoriale.